Realizimi i investimeve me financim të nga buxheti i shtetit sipas destinacionit ka qënë: 2.2 miliard lekë ose 90.6% në ujësjellës dhe 361 milion lekë ose 91.8% në kanalizime.

- Janë vlerësuar nevojat për kosto lokale, taksë doganore dhe rimbursim TVSH-je (në kuadër të financimeve buxhetore), për kontratat e miratuara të financuara nga donatorët e huaj me vlerë prej **1.4 miliard**

lekë, të cilat janë realizuar në vlerën 1.37 miliard lekë, ose në masën 97.8%.

Eshte e rendesishme te theksoj se megjithese TVSH eshte realizuar ne nivel te larte, rezultojne rreth 300 milion leke detyrime te papaguara per TVSH si rezultat i mungeses se fondeve.

- Hartimi i planit për projektet me financim të huaj dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të këtyre projekteve, e shprehur kjo në terma fizike e financiare, është një detyrë tjetër e rëndësishme të cilën DPUK e ka përmbushur me sukses. Në këtë drejtim plani për financimin e huaj **prej 7.79 miliard lekësh është realizuar në vlerën 7.17 miliard lekë ose në masën 92%.**

Realizimi i investimeve me financim të huaj sipas destinacionit ka qenë: 547 milion lekë në ujësjellësa, 4.6 miliard lekë në kanalizime dhe 2 miliard lekë në impiante trajtimi ujrash të ndotura.

- Është punuar gjatë këtij viti në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike për ujësjellësa dhe kanalizime në funksion të përmirësimit të standardeve të projektimit e të standardeve të punës për sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve.
 - Stafi i DPUK-së ka kontribuar për hartimin dhe përgatitjen e projekt akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e administrimit dhe të shpërndarjes së ujit të pijshëm, largimit të organizuar dhe trajtimin e ujrave të përdorura si dhe monitorimin e tyre.
 - Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar një sërë projektesh të reja në sektorin e infrastrukturës ujore të cilët janë analizuar e marrë në konsideratë gjatë hartimit të planit të investimeve 2016.
- Në projekt buxhetin e vitit 2016 është parashikuar që plani i investimeve të financuara nga buxheti të jetë 1.8 **miliard lekë dhe 1.1 miliard lekë për TVSH e kosto lokale** mbështetje për projektet me financim të huaj të cilat janë parashikuar në **vlerën 4.3 miliard lekë** në ujësjellësa, kanalizime e impiante trajtimi ujrash të ndotura.
- Bazuar në analiza të thella tekniko ekonomike, si dhe në bazën ligjore egzistuese, është bërë shpërndarja e subvencioneve prej 430 milion lekësh për 49 shoqëri që kanë rezultuar me diferencë kostoje, ose në masën 100% të fondit të planifikuar.
 - DPUK ka dhënë një kontribut të madh në drejtim të orjentimit të reformës sektoriale. Përgatitja e raporteve dhe mbështetja me

informacion të detajuar (të dhëna, tregues e analiza tekniko ekonomike), ndihmuan procesin e dizenjimit të reformës.

- Kemi Bashkëpunuar me një sërë institucionesh qendrore dhe vendore, donatorë të huaj, shoqata joqeveritare vendase apo të huaja, të interesuara për zhvillimin e sektorit të infrastrukturës ujore duke i mbështetur ato me informacionin e nevojshëm për hartimin e projekteve të zbatimit apo asistencës teknike.
- Edhe gjatë vitit 2015 është hartuar dhe zbatuar një kalendar inspektimesh në të gjitha shoqëritë e UK që kryejnë aktivitetin e tyre në zona turistike të vendit nga Velipoja në Ksamil.
- Është punuar për ndjekjen e ecurisë së projekteve me donatorë të huaj nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve, duke rakorduar punën me Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

E rëndësishme është të theksoj, se një numër i konsiderueshëm projektesh me financim të huaj e nga buxheti, janë në proces zbatimi e monitorimi nga DPUK. Vënia në efikasitet e këtyre investimeve do të japë impakt pozitiv jo vetëm në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ujore por do të përmirësojë ndjeshëm, cilësinë e shërbimeve Ujësjetës-Kanalizime dhe trajtimin e ujrave të ndotura.

Zbatimi i projekteve, në shumicën e rasteve, shtrihet në disa vite dhe impakti i tyre në performancën e shërbimeve, jepet pas përfundimit dhe vënies së tyre në efikasitet.

Ndikimi i investimeve në zgjerimin e shërbimeve UK

Si rezultat i investimeve të kryera në sektor, deri në fund të 9/mujorit 2014, është zgjeruar rrjeti i ujësjetës me → 289 km dhe ai i kanalizimeve → 94 km.

Vënia në shfrytëzim e kësaj infrastrukture, ka bërë që shoqëritë e Ujësjetës Kanalizimeve të zgjerojnë shërbimet e tyre për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Kështu gjatë 9 muorit 2015, janë shtuar 17 mijë lidhje të reja në rrjetin ujësjetës dhe 21,6 mijë lidhje të reja në rrjetin e kanalizimeve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë bërë investime edhe për

matjen e ujit të pijshëm, janë vendosur 22,5 mijë matësa konsumi, të cilët kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi.

Performanca

Trendi pozitiv i zgjerimit të shërbimeve ujësjellës kanalizime, justifikon deri diku investimet e kryera në sektor, por për sa i përket performancës së përgjithshme, ajo vazhdon të jetë e pa kënaqshme. Kjo situatë e shprehur nëpërmjet treguesve kryesorë të performancës për 9 mujorin 2015, paraqitet e tillë:

- Raportet e mbulimit me shërbime :
Nga 80.6% uji i pijshëm në **81.2%**
Nga 49% kanalizimet → në **49.5%**
- Prodhimi vazhdon të jetë shumë më i lartë se kërkesat për ujë → **282 l/f/d**
- Niveli i Shitjeve të ujit është ulur → **93.6 l/f/d nga 95 l/f/d**
- Humbjet vazhdojnë të jenë në nivel shumë të lartë → **66.8% nga 67%**
 - Amortizim i rrjetit
 - Lidhje të paligjshme
 - Niveli i ulët i matjes
 - Mosfaturim i të gjithë klientëve që marrin ujë nga sistemet e ujësjellësit
 - Konfigurimi i sistemeve/kapaciteti i pompave
- Niveli i matjes së konsumit rezulton → **63% nga 61%** që ka qenë 2014
- Kosto totale për shitjen e ujit → **83.6 lekë/m³**
- Çmimi mesatar i ujit të pijshëm → **71.5 lekë/m³**
- Diferenca **12.1 lekë/m³** është kosto e pa mbuluar edhe sikur të arkëtohen 100% të gjitha faturat e ujit;
- Norma e përgjithshme e arkëtimit → **89% nga 82.2%** në 2014
- Raporti i mbulimit të Kostos Direkte të O&M me të ardhurat (UK) → **101% nga 105.2%**
- Raporti i mbulimit të Kostos Totale të O&M me të ardhurat (UK) → **77.3% nga 82.5%**
- Punonjës për 1000 lidhje ujësjellës + kanalizime → **5.5 nga 5.8** në 2014
- Vazhdimësia e furnizimit me ujë → e njëjtë, **12 orë/ditë**

Shqipëria është një vend i pasur me burime të shumta ujore. Uji, si një burim thelbësor për të mbështetur jetën, zhvillimin ekonomik të vendit, turizmin dhe mjedisin, duhet të menaxhohet cilësisht për të mirën e përbashkët.

Për këtë arsye, e gjithë puna e DPUK-së, politikat e qeverisë, investimet dhe monitorimi, janë në funksion të sigurimit të shërbimeve sa më cilësore, pra furnizim me ujë cilësisht të pastër 24 orë në ditë, me kosto sa më të ulët dhe me tarifa të përballueshme për të gjithë qytetarët e vendit, garantimin e sistemeve të sigurta për kanalizimet dhe trajtim të ujrave të ndotura sipas standardeve të BE-së.

Analiza e hollësishme e treguesve të performancës e vitit të kaluar, na mundësoi identifikimin e problematikës që mbart në vetvete sektori si në aspektin teknik, financiar, e menaxherial ashtu edhe në atë ligjor e institucional.

Për sa më sipër, në qendër të vëmendjes ka qenë realizimi i detyrave të përcaktuara në rregulloren e institucionit tonë ashtu si pëmenda më sipër, por njëkohësisht e gjithë puna dhe kontributi i stafit të DPUK gjatë këtij viti, u orjentua drejt një qasjeje të re për të mundësuar realizimin e objektivit final të qeverisë, për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Në funksion të këtij objekti final, u hartua plani jonë i punës dhe u caktuan objektiva shtesë për vitin 2015.

Të gjitha këto do të mundësojnë, rritjen e kapaciteteve teknike e njerëzore në sektor, përmirësimin e mënyrës së funksionimit të shoqërive, çka do të çojë në një menaxhim më të mirë të kërkesës për ujë, në reduktimin e humbjeve e të kostove të pa dobishme.

Realizimi ose jo i objektivave:

- ✓ Kontribut për Reformën në sektor. Për realizimin e këtij objekti, një grup pune i përbërë nga specialistët më me eksperiencë të DPUK-së (4 persona), kanë punuar për disa muaj me radhë së bashku me stafin e MTI caktuar nga ministri, për hartimin e një sërë dokumentash ligjore, të cilët përbëjnë thelbin e reformës sektoriale. Gjatë kësaj periudhe grupi i punës është konsultuar me institucione, shoqëri, dhe donatorë të ndryshëm të cilët kanë interes për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve.

Javën e parë të muajit dhjetor 2015, në një mbledhje të qeverisë, paketa ligjore për reformën në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, u miratu në parim. Jemi në pritje të miratimit të VKM-ve përbërëse të paketës ligjore të reformës pasi një sërë objektivash për vitin që sapo ka nisur, janë të lidhura ngushtësisht apo varen prej tyre.

- ✓ Orientimi i investimeve nga performanca dhe mbi bazën e Master Planit Kombëtar. Për sa i përket këtij objekti, shprehem se gjatë vitit 2015 investimet që DPUK ka financuar nga buxheti i shtetit, përgjithësisht kanë qenë të orientuara nga performanca. Por duhet të sqaroj se është situata e amortizuar e infrastrukturës ujësjellës kanalizime, humbjet e ujit në nivel shumë të lartë, e një sërë faktorësh të tjerë, që janë marë në konsideratë në shpërndarjen e investimeve.

Shpesh, për vazhdimësinë e financimit të investimeve sipas fazave të projekteve, donatorët, në bashkëpunim me koordinatoret e projekteve dhe stafin e Njesisë së monitorimit, bazohen në analizën e një sërë treguesish performace. Pra si garanci për vazhdimin e financimit të investimeve, shpesh ka shërbyer përmirësimi i performancës së shërbimeve.

Për pjesën e dytë të objektivit, që investimet të bazohen në Master Planin Kombëtar të UK, shprehemi se e kemi realizuar nga pikpamja ligjore pasi në të njëjtën mbledhje qeverie të përmendur më sipër, me prezencën edhe të kryetarit të sekretariatit kombëtar të ujit, u miratua Master Plani Kombëtar i investimeve për sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri.

Implementimi, mbetet objektiv për vitin 2016, pasi tashmë kemi bazën ligjore për ta mundësuar këtë gjë. Aktualisht, stafi i drejtorisë teknike në DPUK në bashkëpunim me Stafin e shoqërive UK, bashkive dhe institucioneve tjera, ka filluar punën për përditësimin e Master Planit Kombëtar të ujësjellës kanalizimeve (përfshirja dhe pasqyrimi në të, i investimeve 2010-2015).

- ✓ Intesifikimi i investimeve në matjen e prodhimit dhe konsumit të ujit. Analizat e treguesve të performancës ndër vite, kanë treguar se kur përdoruesit faturohen mbi bazën e konsumit të matur, kërkesa për ujë reduktohet në masë të ndjeshme, duke ndikuar në reduktimin e humbjeve. Gjithashtu, nisur nga fakti se klientët paguajnë vetëm për veten, atë sasi që ata konsumojnë, pra nuk paguajnë për të tjerët, arkëtimet nga shërbimet UK, rriten.

Për këto arsye, investimet nga buxheti apo donatorët janë orientuar nga DPUK drejt intensifikimit të matjes. Numri i matësive të konsumit të ujit

deri në fund të 9/mujorit 2015 si e përmenda më sipër, është rritur me 22.5 mijë. Ky numër do të rezultojë edhe më i madh, referuar të dhënave të fundit të vitit 2015 (në shkurt dalin rezultatet).

- ✓ Orientimi i subvencioneve drejt shtresave në nevojë. Për sa i përket këtij objektivi, në fund të muajit dhjetor 2015 me urdhër të ministrit të MTI, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës, për hartimin e draftit të udhëzimit për procedurat e shpërndarjes së subvencioneve. Zgjidhja edhe e kësaj çështje do të mbetet si objektivi për tu realizuar në vitin 2016. Është e rëndësishme të theksojmë se mosrealizimi i këtij objektivi brenda harkut kohor të vitit 2015 nuk ka ardhur për shkak të neglizhencës së institucioneve tona, por për shkak se:
 - Duhet të ishte finalizuar dhe miratuar paketa ligjore për reformën në sektorin e ujësjellës kanalizimeve, pasi sipas kësaj pakete të re, ka një rindarje të detyrave, kompetencave dhe përgjegjesive ndërmjet aktorëve e faktorëve me impakt në mënyrën e administrimit e menaxhimit, jo vetëm të burimeve natyrore e njerëzore por edhe të atyre financiare;
 - Jemi në pritje të dizenjimit dhe miratimit të një "modeli financiar" që është duke u përgatitur nga një grup ekspertësh të huaj në bashkëpunim me stafin e DPUK dhe MTI në kuadër të një projekti i cili financohet nga Banka Botërore.
Rezultatet e punës, pra modeli, do orientojë grupin e punës, për përcaktimin në mënyrë sa më të drejtë jo vetëm të mënyrës dhe procedurës së subvencionimit të sektorit Ujësjetës kanalizime, por edhe të vlerësimit sa më realist të nivelit të finacimeve në formën e subvencioneve për shtresat e varfra apo për rastet e veçanta të subvencionimit për diferencë kostojë e çmimi.
- ✓ Zgjerimi dhe rritja e cilësisë së monitorimit. Të bindur se monitorimi dhe vlerësimi krahasues i treguesve të performancës, i zbatuar si një proces ciklik e në vazhdimësi, rrit efikasitetin dhe cilësinë e punës së Shoqërive Ujësjetës-Kanalizime, për të siguruar shërbime cilësore e financiarisht të qëndrueshme, kemi intensifikuar punën dhe kërkesat tona për forcimin e monitorimit edhe me teper gjatë vitit 2015.

Në këtë kuadër, përveç procesit të vazhdueshëm të grumbullimit të të dhënave, vlerësimit të situates së furnizimit me ujë e kanalizime nërmjet treguesve të performances dhe hartimit të raporteve të ndryshme, stafi i kësaj drejtorie ka punuar fort për zgjerimin e programit të monitorimit dhe rritjen e cilësisë së tij.

- Zgjerimi i programit. Gjatë vitit 2015 stafi i njësisë së monitorimit dhe benchmarking, ka punuar për përfshirjen në programin e monitorimit edhe të impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura. Ky objektiv është plotësuar në masën 100% edhe me ndihmën e grupit të konsulencës në kuadër të programit WASP. Monitorimi i ITUN do të fillojë në 1 janar të këtij viti, pra konkretizimi i tij mbetet të jetë objektiv për vitin 2016. Në lidhje me këtë çështje, vlen të theksoj se janë përzgjedhur 30 tregues që do të mundësojnë matjen dhe monitorimin e performances për ITUN që janë funksionale në Shqipëri. Gama e të dhënave bazike të nevojshme për llogaritjen e këtyre treguesve, është shumë e gjërë ku janë të përfshira të gjitha fushat si menaxhimi teknik, financiar, organizativ, cilësisë etj.
- Rritja e cilësisë së monitorimit. Ka përfunduar baza e plotë e të dhënave që do të grumbullohen (350 të dhëna) nga të gjitha shoqëritë që do të zhvillojnë aktivitetin UK në kuadër të reformës territoriale e asaj sektoriale. Është përpiluar e miratuar nga drejtori i përgjithshëm, modeli i pyetësorit për rastet që nuk kanë kapacitetet e nevojshme për raportimin on-line si dhe udhëzuesi për plotësimin e të dhënave që do të raportohen (mujore në rastet on-line dhe tremujore në rastet e raportimit nëpërmjet pyetësorit). Janë përcaktuar (87) treguesit nëpërmjet të cilëve do të matet e do të monitorohet performanca e shërbimeve ujësjellës, kanalizime e ITUN.

Në analizën e vitit të kaluar, kam theksuar se, për të qënë të suksesshëm në realizimin e objektivave të vitit 2015, duhet të merren disa masa për përmirësimin e Rregullimit, Menaxhimit dhe Adresimit më të mirë të përgjegjësive, pasi përmirësimi dhe funksionimi me cilësi i shërbimeve Ujësjellës kanalizime, është i lidhur dhe i ndërvuar nga shumë faktorë të tjerë jashtë DPUK.

- Për sa më sipër, kemi rekomanduar, Përgatitjen e legjislacionit për administrimin dhe menaxhimin e impianteve të trajtimit të ujrave të zeza si dhe Krijimin e një Njësie Menaxhimi për impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura, njëkohësisht edhe Mbështetje financiare për një

periudhë 4-5 vjeçare për to. Kjo për arsye të situatës së rëndë financiare të shoqërive UK, të cilat nuk janë në gjendje që me të ardhurat nga shitja të mbulojnë kostot e Ujit të pijshëm e kanalizimeve e jo më kostot për funksionimin normal të ITUN të cilat janë të konsiderueshme.

- Për sa i përket rekomandimit të dytë, që ka të bëjë me garantimin e një procesi të efektshëm Liçensimi për operatorët UK, shprehem se situata edhe gjatë vitit 2015 është e njëjtë me atë të vitit të shkuar.

Vazhdojnë të kenë liçencë një numër i konsiderueshëm shoqërisht, pavarësisht se ato nuk kanë as aftësitë e nevojshme profesionale e as ato financiare për menaxhimin e këtyre shërbimeve publike kaq të rëndësishme. Gjithashtu vlejnë të përmenden edhe rastet e ushtrimit të këtij aktiviteti jetik në kundërshtim me ligjin, pra pa liçensë.

- Tarifa më të mirëstudiuara, për të inkurajuar rritjen e të ardhurave nëpërmjet reduktimit të humbjeve, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të gjenerohen të ardhurat e nevojshme, për mbulimin e kostove, për të garantuar qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve.

Edhe në këtë pike, situata vazhdon të jetë pothuajse e njëjtë. Të ardhurat vijnë në rritje por vetëm për shkak të rritjes së tarifës dhe jo për shkak të reduktimit të humbjeve apo përmirësimit të treguesve të tjerë të performances e shërbimit në tërësi.

Objektivat për vitin 2016.

Objektivat e këtij viti janë të lidhura ngushtësisht me miratimin e VKM-së për organizimin dhe funksionimin e AKUKMN si dhe të miratimit të strukturës së saj. Kjo për arsye se DPUK, e transformuar në AKUKMN, shoqërohet me ndryshime thelbësore në mënyrën e konceptimit të institucionit, strukturës së tij, ushtrimit të kompetencave, marrjes së përgjegjesive, etj. Kështu, përveç faktit që shtohen, 3 Drejtoritë rajonale si dhe drejtoria e Menaxhimit të mbetjeve të ngurta, drejtoria juridike, ka edhe ndryshime brënda strukturave të drejtorive aktuale. Edhe marrëdhëniet apo kompetencat e AKUKMN në raport me shoqëritë e UK janë fare të ndryshme.

Duke e marrë të mirëqënë cështjen e transformimit të DPUK në AKUKMN, objektivat tona për vitin 2016 janë:

- Plotësimi brenda një kohe të shkurtër i organikës së institucionit tonë në përputhje me strukturën organizative të tij, e cila pritët të miratohet me VKM.
- Hartimi i rregullores së re të AKUKMN, bazuar në kompetencat dhe detyrat që i ngarkohen këtij institucioni, në zbatim të VKM-se perkatese. Pershkrimi i detyrave sipas vendeve të punës për të mundësuar efikacitet sa më të lartë në realizimin e objektivave.
- Mbështetje maksimale për shoqëritë UK dhe marrja e masave të nevojshme në drejtim të Zbatimit të Reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve;
- Organizimi dhe zhvillimi i seminarit në nivel kombëtar me temë "10 vjet Benchmarking për një vendim marrje realiste drejt përmirësimit të performancës së shërbimeve ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri".
- Do të punojmë në mënyrë të tillë që Investimet të jenë më të plota, të mirëstudjuara, të orientuara kryesisht nga performanca dhe të bazuara në Master Planin Kombëtar të Ujësjellës kanalizimeve;
- Forcimi i kontrollit të projekteve në infrastrukturën UK, për të bërë të mundur garantimin e standardeve sa më të larta në projektimin dhe zbatimin e tyre;
- Intesifikimi i inspektimeve në terren / objekte, për një monitorim më të efektshëm të realizimit të investimeve;
- Intesifikim më i madh i punës nga Njesitë e zbatimit të projekteve dhe Monitorimi më i afër i projekteve me financim të huaj për të bërë të mundur realizimin e objekteve në afatet e paracaktuara;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme me bazën përkatëse të të dhënave duke rritur nivelin e bashkëpunimit me institucionet si Ministria e Punës e Mirëqenies Sociale, ERRU, etj, për të mundësuar vlerësimin real të nevojave për subvencione për shtresat në nevojë dhe diferencë kosto;
- Bashkëpunim me institucionet perkatese, për hartimin e një udhëzuesi për shpërndarjen e subvencioneve për të dy kategoritë (diferencë kosto dhe shtresa në nevojë)
- Realizimi i raportimit on-line që në tremujorin e parë të vitit 2016, për të gjitha shoqëritë e UK të cilat disponojnë kapacitetet e nevojshme

njerëzore dhe teknologjinë e duhur; Soft-ware ka perfunduar se bashku me manualin e perdoruesit dhe bazen e te dhenave, do punojme intensivisht per ta vene ne eficence programin e ri.

- Per here te pare do te përfshihen në programin e monitorimit edhe te dhenat per shërbimin e trajtimit te ujrave të ndotura, per të gjithë ITUN-të funksional në Shqipëri. Hedhja e bazave per krijimin e historikut mbi funksionimin e ITUN;
- Përgatitja e raporteve të performances për sektorin dhe cdo sh.a. UK si dhe paraqitja on-line e atyre që konsiderohen më kryesore;
- Themelimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit dhe certifikimit, për stafin e shoqërive të ujësjellës kanalizime si dhe burimeve njerëzore prane bashkive të cilët kanë lidhje me këto shërbime, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Entin Rregullator të Ujit;
- Përcaktimi i treguesve që duhet të arrijë çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve dhe trajtimit te ujrave te ndotura dhe hartimi e monitorimi i kontratave të performancës.
- Per vitin 2016 do te punohet edhe ne drejtim te rritjaes se kapaciteteve te burimeve njerezore, brenda institucionit tone;
- Do te organizojme edhe me mire punen per monitorimin e kontratave dhe zbatimin e punimeve per projektet me financim nga buxheti;
- Jemi duke punuar per dizenjimin e nje faqe te re ne Web, per te mundesuar nivel me te larte transparence per te gjitha aktivitetet e institucionit tone si dhe per krijuar te gjitha mundesite e marrjes se informacionit te nevojshem per sherbimet UK, si nga institucionet ashtu edhe nga publiku.

Ardian Alushi

Drejtore i Përgjithshëm

DREJTORIA E PËRGJITHSHME UJËSJELLËS KANALIZIME

Analize e Projekteve me Financim të Huaj në Programin Ujësjiellës – Kanalizime për vitin 2015

Në planin buxhetor të vitit 2015 për projektet me financim të huaj u planifikuan 7,799,272,000 lekë disbursime nga donatorët e huaj nga të cilat u realizuan 7,459,594, lek ose 96% e fondeve.

Mbështetja me TVSH dhe Kosto Lokale nga buxheti i shtetit për projektet me financim të huaj u planifikua në vlerën 1,441,175,000 lekë nga të cilat u realizuan 1,371,311,000lekë ose 95 % e fondeve.

Me buxhetin e vitit 2015 u planifikuan fonde për 24 projekte ku:

4 ishin projekte të reja

3 projekte përfunduan punimet

17 projekte do të vazhdojnë punimet me buxhetin e planifikuar për vitin 2016

Përshkrim i shkurtër për ecurinë e projekteve ku ka patur vazhdimësi punimesh

1. Menaxhimi i mbetjeve Urbane të Tiranës (faza e dytë, impianti i pastrimit të ujërave të ndotura)

Vlera: 1,123,000 euro

Donatori: Q. Italiane

Afati: 2014-2016

Planifikuar: 14,220,000 lekë

Realizuar: 7,169,000 lekë (50%)

Realizimi progresiv fizik:0%

2. Projekti I Kanalizimeve Korça III dhe IV IPA 2010

Vlera: 4,018,000 euro

Donatori: KE

Afati: 2012-2015

Planifikuar: 350,948,000 lekë

Realizuar: 261,254,000 (74%)

Realizimi progresiv fizik:95%

3. Furnizimi me ujë dhe sanitetit në Orikum

Vlera: 13,351,000 dollar

Donatori: Banka islamike

Afati: 2012-2016

Planifikuar: 408,598,000 lekë

Realizuar: 274,573,000 (67%)

Realizimi progresiv fizik:85%

4. Furnizimi me ujë dhe mbrojtja mjedisore e liqenit të Shkodrës

Vlera: 19,450,000 euro

Donatori: KFW,SECO,ADA

Afati: 2009-2015

Planifikuar: 160,000,000 lekë

Realizuar: 130,760,000 (82%)

Realizimi progresiv fizik:100%

5. Projekti i kanalizimeve të Tiranës së madhe

Vlera: 9.1 mld JPY

Donatori: JICA

Afati: 2009-2019

Planifikuar: 800,000,000 lekë

Realizuar: 1,114,743,000 (139%)

Realizimi progresiv fizik:22

6. Ndertimi i rrjetit të KUZ (Vlore, Ksamil, Kavaje dhe Shengjin) , IPA 2009

Vlera: 14,381,885 Euro
Donatori: KE
Afati: 2012-2016
Planifikuar: 905,092,000 lekë
Realizuar: 490,790,463 (53%)
Realizimi progresiv fizik: 67%

7. Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, Kanalizimet e Ujrave të Zeza Pogradec (faza III)

Vlera: 13,461,267 Euro
Donatori: KFW
Afati: 2011-2016
Planifikuar: 811,369,000 lekë
Realizuar: 489,176,000 (60%)
Realizimi progresiv fizik: 80%

8. Programi i infrastrukturës komunale I për qytetet Fier, Gjirokaster, Sarandë, dhe Lezhë

Vlera: 30,621,000 euro,
Donatori: KFW, EU, SECO
Afati: 2011-2017
Planifikuar: 1,150,925,000 lekë
Realizuar: 1,475,000,000 (128%)
Realizimi progresiv fizik: 63%

9. Programi I infrastrukturës komunale II për qytetet Kamez, Lushnje, Berat, Kucove, Fier dhe Sarandë.

Vlera: 34,482,000 euro,
Donatori: KFW, EU,SECO
Afati: 2011-2017
Planifikuar: 1,200,000,000 lekë
Realizuar: 1,773,762,000 (148%)
Realizimi progresiv fizik:41%

10. Furnizimi me ujë Peshkopi

Vlera: 4,000,000 euro,
Donatori: Q.Austriake
Afati: 2014-2016
Planifikuar: 200,000,000 lekë
Realizuar: 267,050,000 (134%)
Realizimi progresiv fizik:67%

11. Perfundimi I sistemit te KUZ dhe ITUP në zonën e Velipojës Faza e III - të IPA 2011

Vlera: 7,989,373euro,
Donatori: KE
Afati: 2014-2016
Planifikuar: 405,909,000 lekë
Realizuar: 327,525,380 (80%)
Realizimi progresiv fizik:59%

12. Kanalizimet e ujrave te perdorura ne qytetin e Bilishtit

Vlera: 3,000,000 euro,
Donatori: Q.Austriake
Afati: 2014-2016
Planifikuar: 120,000,000 lekë
Realizuar: 170,697,000 (142%)
Realizimi progresiv fizik:48%

13. Makineri e pajisje per ITUP Velipoje faza III, IPA 2011

Vlera: 1,267,313 euro,
Donatori: KE
Afati: 2015-2015
Planifikuar: 177,423,000 lekë
Realizuar: 118,225,000 (67%)
Realizimi progresiv fizik:64%

14. Projekti i ri I furnizimit me uje për qytetin Durrës

Vlera: 62,500,000 euro,
Donatori: BB
Afati: 2014-2019
Planifikuar: 196,903,000, lekë
Realizuar: 0 (0%)
Realizimi progresiv fizik:0%



**Drejtoria e
Përgjithshme
e Ujesjellës
Kanalizimeve**

Dt.03/02/2015

R A P O R T

**ANALIZA VJETORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
UJËSJELLËS KANALIZIMEVE**

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Pasqyrim i përgjithshëm i punës së DPUK-së për vitin 2014 → **Z. Ardian Alushi** Drejtor i Përgjithshëm i DPUK-së:

- Analizë e performancës së Sektorit Ujësjiellës – Kanalizime;
- Realizimi i detyrave të përgjithshme;

Raport mbi përshkrimin e objektivave të realizuar gjatë vitit 2014 dhe objektivat për vitin 2015:

- Drejtoria Teknike
- Drejtoria Ekonomike
- Drejtoria e Monitorimit

Ecuria dhe problematika e projekteve me financim të huaj

- Projekte të financuara nga KFW
- Projekte të financuara nga Banka Islamike
- Projekte të financuara nga kooperacioni Italian
- Projekte në kuadrin e programeve IPA
- Projekte të financuara nga BB
- Projekte financiar nga qeveria Japoneze Jica

Objektivat dhe sfidat e DPUK-së për vitin 2015

AKTIVITETET DHE DETYRAT E REALIZUARA NGA DPUK

GJATË VITIT 2014

Nisur nga fakti se uji i pijshëm është elementi më i domosdoshëm për jetën dhe furnizimi me ujë e kanalizimet, janë shërbime të një natyre të veçantë "Monopol", ku publiku nuk ka mundësi zgjedhje, parimi mbi të cilin bazohen të gjitha politikat e strategjitë sektoriale, është ofrimi i shërbimeve cilësore, me kosto sa më të ulët e me tarifa të drejta e të përballueshme nga publiku.

Ndër sfidat më të mëdha për sektorin dhe DPUK në mënyrë të veçantë, ka qënë realizimi i objektivit, - furnizimi me ujë të pijshëm i gjithë popullsisë së vendit; zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve dhe përballimi i ndotjes së madhe të shkaktuar nga shkarkimet e ujrave të zeza e atyre industriale, në lumenj, dete dhe liqene. Zgjerimi i mundësive për ofrimin e këtyre shërbimeve, rritja e cilësive së tyre dhe sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK, ka qënë në fokusin e punës sonë edhe gjatë vitit 2014.

DPUK, zhvillon aktivitetin dhe realizon objektivat e saj nëpërmjet tre drejtorive: Drejtorisë Teknike, Drejtorisë së Financës e asaj të Monitorimit të projekteve të huaja e Benchmarking si dhe nëpërmjet Njësive të Zbatimit të Projekteve me financim të huaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës Kanalizimeve, është organi i vetëm shtetëror, i specializuar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizimeve të ujrave të zeza e trajtimit të tyre, e cila mbështet teknikisht politikat e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës në këtë fushë.

Kjo drejtori nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik:

- ✓ koordinon kërkesat për investime me burimet përkatëse të financimit duke ndjekur edhe ecurinë e zbatimit të projekteve;
- ✓ detajon dhe shpërndan subvencionet sipas planit të buxhetit;
- ✓ monitoron në vazhdimësi e me profesionalizëm, performancën e sektorit.

Menaxhimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve e trajtimit të ujrave të ndotura, është detyrë e shoqërive UK, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në bazë të ligjit të shoqërive tregtare;

Pushtetet vendore duke qënë pronare të aksioneve të këtyre shoqërive, kanë përgjegjësinë për administrimin e shoqërive UK dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për komunitetin e tyre.

DPUK, gjatë vitit 2014, ka bërë një punë të madhe në drejtim të zbatimit të kuadrit strategjik të sektorit të ujësllës kanalizimeve, ku një ndihmë të madhe, ka dhënë **monitorimi** i 56 shoqërive që zhvillojnë aktivitetin e furnizimit me ujë e kanalizimeve në Shqipëri, si dhe monitorimi dhe zbatimi i investimeve.

Shqipëria është një vend i pasur me burime të shumta ujore. Uji, si një burim thelbësor për të mbështetur jetën, zhvillimin ekonomik të vendit, turizmin dhe mjedisin, duhet të menaxhohet cilësisht për të mirën e përbashkët.

Për të qartësuar çështjen se si menaxhohet uji i pijshëm në Shqipëri, për të evidentuar problematikën aktuale, apo edhe atë të trashëguar nga e kaluara, po paraqes shkurtimisht situatën e sektorit ujësllës-kanalizime nëpërmjet disa prej treguesve kryesorë të performancës.

Kapaciteti i burimeve

Bazuar në të dhëna mesatare vjetore të monitorimit, rezulton se :

- Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve që aktualisht përdoren për prodhimin e ujit të pijshëm, është → **606 milion m³ ujë**.
- Volumi total i ujit të prodhuar nga të dy llojet e sistemeve, është → **277 milion m³ ujë/vit**, (koeficienti i shfrytëzimit të kapacitetit të burimeve, rezulton → **46%**).

- Kërkesat për ujë të pijshëm, të llogaritura për të gjithë popullsinë e juridiksionit të shoqërive të monitoruara, vlerësohen → **217 milion m³** ujë/vit, (vlerësimi identifikon faktin se oferta për ujë është **29%** më e lartë se kërkesa).
 - Faturohen mesatarisht → **91.5 milion m³** ujë në vit ose → **33%** e volumit të ujit të prodhuar.
- Paraqitja grafike, jep imazhe të qarta mbi "jo efektivitetin" e përdorimit të burimeve ujore në Shqipëri.



Raportet e mbulimit me shërbime:

- Popullsia në juridiksionin e shoqërive të monitoruara → **3.3 milion banorë;**
- Furnizohen me ujë nga sistemet që administrohen nga sh.a.UK → **2.6 milion banorë;**
- Kanë lidhje me sistem kanalizimesh rreth → **1.6 milion banorë.**

Bazuar në këto të dhëna,

- raporti i mbulimit me ujë të pijshëm rezulton → **80.3%** ;
- raporti i mbulimit me kanalizime rezulton → **47.9%**.

→ **20%** e popullsisë së pa mbuluar me shërbimin e furnizimit me ujë:


- Pjesërisht furnizohet nga puse individuale;
- Pjesërisht marrin ujë nga sisteme të vegjël që administrohen nga vetë komunat;
- Një pjesë tjetër e kësaj popullsie merr ujë nëpërmjet lidhjeve të paligjshme;
- Dhe së fundi, një pjesë e popullsisë merr ujë nga sistemi i shoqërisë, por kjo e fundit nuk i ka paisur me kontrata e si të tillë nuk janë të identifikuar si klientë të saj.

Vlen të përmendet se 28 nga 56 shoqëritë e monitoruara ofrojnë të dy shërbimet (ujësjellës e kanalizime), ndërsa 28 të tjera ofrojnë vetëm furnizimin me ujë të pijshëm.


Investimet

Gjatë vitit 2014, në infrastrukturën e ujësjellës kanalizimeve janë realizuar → **10.3 miliard lekë** investime, kundrejt → **5.6 miliard lekëve** të realizuara në vitin 2013, ose 83% më shumë.

Klasifikimi i investimeve sipas destinacionit është: → **2 miliard lekë** në ujësjellësa; → **4.4 miliard lekë** në kanalizime dhe → **3.9 miliard lekë** në impiantet e trajtimit të ujrave të zeza.




→ **2.9 miliard lekë** ose 28% e investimeve të realizuara gjatë vitit 2014, janë financuar nga buxheti i shtetit dhe → **7.3 miliard lekë** ose 72% e tyre, është financim i huaj në formë grand apo kredi.



Monitorimi i Rrjetit

Si rezultat i investimeve të kryera në sektor, është zgjeruar rrjeti i ujësjellësit me → **331.6 km** dhe ai i kanalizimeve → **52 km**.

Trendi pozitiv për sa i përket zgjerimit të rrjetit ujësjellës kanalizimeve, justifikon investimet e kryera në sektor.



Monitorimi i lidhjeve në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.


Zgjerimi i rrjeteve ujësjellës e kanalizime, shoqërohet edhe me shtimin e numrit të lidhjeve. Gjatë 9 muajve të vitit 2014, në sektor janë shtuar rreth :

→ **21.3 mijë lidhje të reja në rrjetin ujësjellës**

→ **16.9 mijë lidhje në sistemin e kanalizimeve.**

Për të njëjtën periudhë janë → **instaluar 23.8 mijë matës** për konsumin e ujit, çka do të thotë se konsumatorët nisur nga fakti se paguajnë mbi bazën e leximit të matësit, kursejnë ujin e pijshëm.

Aktualisht → 61% e lidhjeve të ujit, (klienteve) janë të paisura me matës konsumi. Matja e konsumit të ujit ka gjithashtu trend pozitiv prej vitit 2007.



2.2.1 Monitorimi i ujit pa të ardhura & Niveli i matjes së prodhimit

Nga të dhënat e monitorimit, rezulton se vetëm → **8 shoqëri e matin 100%** prodhimin e ujit, → **19 prej tyre e vlerësojnë 100%** atë dhe → **28 të tjera** pjesërisht e matin dhe pjesërisht e vlerësojnë prodhimin.


Gjatë periudhës 9 mujore rezultojn:

- → **Prodhuar 205.8 milion m³ ujë**
- → **Faturuar 67 milion m³**

Diferenca prej → **138.8 milion m³ ose 67.45%**, përfaqëson volumin e ujit që nuk gjeneron të ardhura (humbjet).

Arsyet e humbjeve në nivele kaq të larta janë:


- Mungesa e matësave të ujit në prodhim dhe konsum;
- Amortizimi i rrjetit;
- Lidhjet e paligjshme;
- Mos faturimi i të gjithë klientëve që marrin ujë nga rrjeti i ujësjellësit;
- Moszbatimi i normativës së konsumit, në mungesë të matësit;
- Humbjet e lejuara të projektimit;
- Natyra e sistemit të pompimit;
- Mungesa e kapaciteteve të duhura menaxhuese.




Monitorimi i situatës dhe analiza e trendit prodhim-shitje nga viti 2007-2014, tregon qartësisht se niveli i humbjeve megjithë luhatjet e pa llogaritshme, është në nivel shumë të lartë rreth (67%). Pamja grafike eidenton këtë fakt.

Rezultate financiare

- **Kosto Totale** e Operimit U+K për 9 mujorin 2014 rezultojn → **5.9 miliard lekë**.
Peshën specifike më të madhe në strukturën e koston totale e ka:
- kosto e energjisë elektrike 24%;
 - kosto pune + sigurime shoqërore e shëndetsore 32%;
 - amortizimi 19%;



- Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e shitjes rezultojnë → **4.7 miliard lekë**
- Janë Arkëtuar → **4.1 miliard lekë**
- Vlera e faturave të pa arkëtuar rezultojnë → **633 milion lekë**
- Subvencionet e shpërndara kanë qënë → **441 milion lekë**
- Kostos totale e pa mbuluar me të ardhurat rezultojnë → **767 milion lekë**



Bazuar në të dhënat financiare rezultojnë se:


- **69.2%** e KTO mbulohet me arkëtimet,
- **7.4%** e KTO mbulohet me subvencione
- **23.4%** e KTO mbetet zbuluar (përfshirë edhe mosarkëtimi).

Është e rëndësishme të përmend faktin se → **57%** e volumit të ujit të pijshëm, prodhohet nëpërmjet stacioneve të pompimit, proces ky që shoqërohet me konsum të lartë të energjisë elektrike. Funksionimi i 10 impianteve të trajtimit të ujrave të zeza në disa qytete të vendit si: Kavajë, Korçë, Pogradec, Vlorë, Sarandë, Lezhë, Shirokë, Durrës etj, ka rritur ndjeshëm vlerën e faturës së energjisë e cila për një vit kap vlerën → **1.8 miliard lekë**.

Lidhur me këtë çështje, DPUK ka punuar edhe në drejtim të vlerësimit të detyrimeve, që Shoqëritë e Ujësjetellës Kanalizimeve kanë për faturat e pa paguara të energjisë elektrike të cilat deri në fund të shtatorit 2014,

rezultojnë → **2.4 miliard lekë**.

Cilësia e shërbimit



Kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë në shkallë vendi rezulton rreth → **12 orë/ditë**. Janë vetëm 4 shoqëri si UK Korçë, Bilisht, Librazhd dhe Rubik që kanë furnizim 24 orë/ditë pa ndërprerje si dhe Gramshi, Lezha, Fieri, Pogradeci, Shkodra dhe Erseka që kanë mbi 20 orë/ditë.

Për sa i përket cilësisë së menaxhimit rezultojnë → **5.4 punonjës për 1000 lidhje UK**, tregues i lartë që pasqyron efiçencë të ulët menaxhimi.

Kjo analizë eidenton problematikën që aktualisht na shqetëson të gjithëve:

Rezultatet treguan se :

- Prodhoet shumë më tepër ujë i pijshëm, se sa janë vlerësuar kërkesat për të;
- Niveli i matjes së prodhimit e konsumit të ujit, vazhdon të jetë shumë i ulët;
- Faturimi 33% i ujit të prodhuar e humbjet 67%, nuk mund të vazhdojnë në këto nivele;
- Rrjeti i shpërndarjes mjaft i amortizuar; në shumë zona të vendit sidomos në qytetet e vogla;
- Vazhdojnë të jenë evidente Lidhjet e paligjshme dhe mosfaturim i të gjithë klientëve;
- Kosto e shitjes së shërbimeve, shumë herë më e lartë se çmimi mesatar i tyre;
- Niveli i arkëtimeve vazhdon të jetë i ulët sidomos nga entet private;
- Pa aftësia paguese vazhdon të jetë e lartë;
- Staf shumë i madh në numër dhe jo i kualifikuar sa dhe si duhet, për të menaxhuar dhe administruar shërbimet e ujësjetellës-kanalizimeve;
- Cilësia e shërbimeve në shumicën e rasteve, larg standardeve;
- Akoma nuk po gjen zbatim ligji për shoqëritë tregëtare që rezultojnë me humbje;
- Papërgjegjshmëri nga ana e Njërive Vendore dhe këshillave mbikqyrëse për sa i përket zbatimit të ligjit 8652;
- Mosfunksionimi i duhur i mekanizmave të rregullimit Licenca – Tarifa – standarde shërbimi;
- Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ndër institucional, jo në nivelin e duhur;
- **DPUK, nuk ka kompetencat e duhura për të ndikuar më mirë në përmirësimin e situatës;**

Në këto rrethana, shprehem se reformimi i thellë dhe i shpejtë i sektorit, është i nevojshëm dhe i domosdoshëm, aq më tepër në kushtet e zbatimit të ndarjes së re administrative dhe zgjedhjeve vendore që priten të zhvillohen qershor të këtij viti.

Shumë detyra të tjera, janë kryer nga stafi i DPUK gjatë vitit 2014, ndër të cilat do të veçoj:

- Hartimi i planit të investimeve që financohen nga buxheti i shtetit, duke u mbështetur në nevojat e paraqitura nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Sh.a Ujësjiellës Kanalizime për realizimin e të cilit, janë bërë të gjitha përpjekjet nga drejtoritë përkatëse në përputhje me grafikun e punimeve dhe standardet e kërkuara. Kështu plani i investimeve buxhetore **prej 3.4 miliard lekë u realizua në vlerën 3 miliard lekë ose në masën 88%.**
- Janë vlerësuar nevojat për kosto lokale, taksë doganore dhe rimbursim TVSH-je (në kuadër të financimeve buxhetore), për kontratat e miratuara të financuara nga donatorët e huaj me vlerë prej **1.38 miliard lekë, të cilat janë realizuar në vlerën 1.36 miliard lekë, ose në masën 99%.**
- Hartimi i planit për projektet me financim të huaj dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të këtyre projekteve, e shprehur kjo në terma fizike e financiare, është një detyrë tjetër e rëndësishme të cilën DPUK e ka përmbyllur me sukses. Në këtë drejtim plani për financimin e huaj **prej 8.3 miliard lekësh është realizuar në vlerën 7.3 miliard lekë ose në masën 88%.**
- Është punuar gjatë vitit 2014 dhe janë bërë përpjekje në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike për ujësjiellësa dhe kanalizime në funksion të përmirësimit të standardeve të projektimit e të standardeve të punës për sektorin e Ujësjiellës Kanalizimeve.
- Stafi i DPUK-së ka kontribuar për hartimin dhe përgatitjen e projekt akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fushën e administrimit dhe të shpërndarjes së ujit të pijshëm, largimit të organizuar dhe trajtimin e ujrave të përdorura si dhe monitorimin e tyre. Një Projekt Vendim i propozuar nga ne për këto çështje, na është komunikuar nga Ministria e linjës, se do të trajtohet duke u përfshirë brenda Reformës Sektoriale.
- Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar një sërë projektesh të reja në sektorin e infrastrukturës ujore të cilët janë analizuar e marrë në konsideratë gjatë hartimit të planit të investimeve 2015. Në projekt buxhetin e vitit 2015 është parashikuar që plani i investimeve të financuara nga buxheti të jetë **2 miliard lekë dhe 1.6 miliard lekë për TVSH e kosto lokale** mbështetje për projektet me financim të huaj të cilat janë parashikuar në **vlerën 11.3 miliard lekë** në ujësjiellësa, kanalizime e Impiante trajtimi ujrash të ndotura.
- DPUK ka dhënë një kontribut të madh në drejtim të orjentimit të reformës sektoriale. Përgatitja e raporteve dhe mbështetja me informacion të detajuar (të dhëna, tregues e analiza tekniko ekonomike), po ndihmojnë procesin, drejt dizenjimit të një reforme sa më realiste e efçente me objektiva të qarta për të garantuar shërbime sa më cilësore, me kostot e domosdoshme e të drejta, dhe me tarifa të përballueshme nga publiku i gjerë duke zbatuar skema sa më efikase subvencionimi për shtresat e varfra.
- Kemi Bashkëpunuar me një sërë institucionesh qëndrore dhe vendore, donatorë të huaj, shoqata joqeveritare vendase apo të huaja, të interesuara për zhvillimin e sektorit të infrastrukturës ujore duke i mbështetur ato me informacionin e nevojshëm për hartimin e projekteve të zbatimit apo asistencës teknike.
- Gjatë vitit 2014 është hartuar dhe zbatuar një kalendar inspektimesh në të gjitha shoqëritë e UK që kryejnë aktivitetin e tyre në zona turistike të vendit nga Velipoja në Ksamil si dhe Korçë Pogradec, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve gjatë sezonit turistik 2014. Grupi i punës, zhvilloi takime në vend me drejtuesit e shoqërive të përfshira në kalendar, me të gjithë kryetarët e bashkive dhe përfaqësues të këshillave të tyre mbikqyrëse.
- Gjithashtu, është punuar me intesitet të lartë për vënien në punë të disa investimeve të përfunduara prej më se dy vjetësh, si impianti i Lezhës e Sarandës, të cilët për arsye të moskoordinimit të mirë të punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, nuk ishin vënë në efçencë. Funksionimi normal e me kapacitet të plotë i këtyre impianteve, mundësuan përmirësimin e cilësisë së ujrave të detit në këto zona, çka ndikoi pozitivisht në perceptimin


e qytetarëve e turistëve, se shërbimet publike të ujësjellës kanalizimeve, po përmirësohen ndjeshëm sidomos në zonën turistike.

- Është punuar për ndjekjen e ecurisë së projekteve me donatorë të huaj nëpërmjet njësive të zbatimit të projekteve, duke rakorduar punën me Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

E rëndësishme është të theksoj se një numër i konsiderueshëm projektesh me financim të huaj e nga buxheti, janë në proces zbatimi e monitorimi nga DPUK. Vënia në efikasitet e këtyre investimeve do të japë impakt pozitiv jo vetëm në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ujore por do të përmirësojë ndjeshëm, cilësinë e shërbimeve Ujësjellës-Kanalizime dhe trajtimin e ujrave të ndotura për rreth 1.5 milion banorë.

Gjatë 10 vjeçarit të fundit Kontributi i donatorëve në financimin e projekteve UK, ka qënë i konsiderueshëm, ku ndër më të rëndësishmet do të përmend:

INVESTIMET 2005-2014 SIPAS DONATOREVE



1. Përmirësimi i Sistemit të kanalizimeve dhe Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura të Tiranës së Madhe

Vlera: 64 milion EURO
Afati: 2014-2016
Donatori: JICA

2. Projekti i ri i furnizimit me ujë për qytetin e Durrësit

Vlera: 62.5 milion EURO (Kredi)
Afati: 2014-2019
Donatori: PIU BB

3. Programi i Infrastrukturës Komunale I - në Qytetet Fier, Gjirokastrë, Sarandë, Lezhë

Vlera: 30,6 milion Euro; 16 milion Euro (kredi) e bute nga KFW, 4,6 milion Euro (Grant) nga Bashkimi Europian dhe 10 milion Euro (Grant) nga Qeveria e Zvicres (SECO)
Afati: 2011-2017
Donatori: KFW, Bashkimi Europian (BE), Qeveria Zviceriane

4. Programi i Infrastrukturës Komunale II – Qytetet Kamëz, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Fier, Sarandë

Vlera: 34,5 milion Euro; 14 milion Euro (Kredi) e bute nga KFW dhe 20,4 milion Euro (Grant) nga Bashkimi European (BE)
Afati: 2012-2017
Donatori: KFW, Komiteti European (KE)

5. **Programi i Infrastrukturës Bashkiake III & IV – Qytetet Berat, Kuçovë, Gjirokaster, Kamzë, Lushnjë, Delvinë, Librazhd**
Vlera: 35 milion euro kredi e butë nga KfW, 4.14 milion euro grant nga KFW dhe 11 milion euro Grand nga SECO (Qeveria e Zvicres).
6. **Master-Plani kombetar i furnizimit me uje te pijshem, largimit dhe trajtimit te ujrave te perdorura**
Procedura në vijim konsiston në miratimin e studimit nga Këshilli i Ministrave.
7. **Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, Kanalizimet e Ujërave të Zeza Pogradec (Faza III)**
Vlera: 13,5 milion Euro 10milion Euro (Kredi) KFW dhe 3,5 milion Euro (Grand) CEB
Afati: 2011-2016
Donatori: CEB dhe KFW
8. **Projekti i Kanalizimeve Korça III dhe IV, IPA 2010**
Vlera: 4 milion Euro (Grand)
Afati: 2012-2015
Donatori: Komiteti European (KE)
9. **Furnizimi me ujë i Qytetit Bilisht**
Vlera: 7.5 milion EURO (Kredi)
Afati: 2012-2014
Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë
Kontraktor Duktus Austri
10. **Kanalizimet e ujërave të përdorura në qytetin e Bilishtit**
Vlera: 3 milion EURO (Kredi)
Afati: 2014-2016
Donatori: Q. Austriake Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë
Firmosja e Kontratës: 30.06.2014
11. **Furnizimi me ujë i Qytetit Peshkopi**
Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë "Turn key Silver Book"
Vlera: 4 milion EURO (Kredi)
Afati: 2014-2016
Donatori: Q. Austriake
12. **Përfundimi i sistemit të KUZ dhe ITUP në Vlorë, IPA 2012**
Vlera: 21.2 milion EURO (Grant)
Afati: 2012-2016
Donatori: Komiteti European (KE) dhe Q. Shqiptare
13. **Furnizimi me ujë dhe mbrojtja mjedisore e Liqenit të Shkodrës**
Vlera: 19.4 milion EURO (Grand + Kredi)
Afati: 2009-2014
Donatori: KFW, ADA, SECO dhe Q. Shqiptare
14. **IPA 2009, Lot 1- Ndërtimi i rrjetit KUZ në Vlorë dhe Ksamil, LOT 2 - Zgjerimi i ITUZ Kavajë, Lot 3 - Ndërtimi i rrjetit KUZ në Shëngjin**
Vlera: 14.3 milion EURO (Grand)
Afati: 2012-2015

Donatori: Komuniteti European (KE)

15. Furnizimi me Ujë dhe Sanitetit në Orikum

Vlera: 13.3 milion DOLLAR (Kredi)
Afati: 2009-2015
Donatori: Banka Islamike

16. Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës

Vlera: 10.3 milion EURO (Kredi)
Afati: 2014 – 2016
Donatori: Qeveria Italiane

17. Rrjeti i KUZ-së për Plazhin (Përroi i Agait-Ura e Dajlanit) dhe linja e dërgimit për në ITUP Durrës, IPA 2007 (Lot 2)

IPA 2007: LOTI 2
Vlera: 9.8 milion EURO (Grant)
Afati: 2011-2014
Donatori: Komiteti European (KE)

18. Projekti i Administrimit dhe i Menaxhimit të Tokës, komponenti D Ndërhyrje emergjente në zonën Shkodër - Lezhë

Vlera: 9.1 milion EURO (Kredi) IBRD dhe 0.4 milion DOLLAR (Kredi) IDA
Afati: 2011-2013
Donatori: IBRD, IDA

19. Përfundimi i sistemit të KUZ dhe ITUP në zonën e Velipojës, Faza III-IPA 2011

Vlera: 7.9 milion EURO (Grant)
Afati: 2014-2016
Donatori: Komiteti European (KE)

20. Ndërtimi i sistemit të ri të KUZ-së në zonën turistike Golem-Kavajë, IPA 2007 (Lot 1)

IPA 2007: LOTI 1
Vlera: 4.3 milion EURO (Grant)
Afati: 2009-2014

21. Ndërtimi i rrjetit të KUZ-së në zonën Velipojë dhe Shkodër IPA 2007 (Lot 4 dhe 5), (Punimet 2 dhe 3)

Vlera: 3.8 milion EURO (Grant)
Afati: 2011-2014
Donatori: Komiteti European (KE)

22. Linja e dërgimit të KUZ-së për qytetet e Lezhës dhe Shëngjinit në ITUP Lezhë, IPA 2007 (Lot 3)

IPA 2007: LOTI 3
Vlera: 3.7 milion EURO (Grant)
Afati: 2010-2013
Donatori: Komiteti European (KE)

23. Përfundimi i sistemit të KUZ-së në zonën e Velipojës, IPA 2010

Vlera: 3.4 milion EURO (Grant)
Afati: 2011-2014
Donatori: Komiteti European (KE)

24. Menaxhimi i Mbetjeve Urbane të Tiranës, (faza e 2-të, impianti i pastrimit të ujërave të ndotura)

Vlera: 1.1 milion EURO (Kredi)
Afati : 2014 – 2016
Donatori: Qeveria Italiane

25. Periferitë Urbane të Tiranës - Komponenti Infrastrukturor (shtesë kontrate) 937,517.50 euro

Vlera: 0.9 milion EURO (Kredi)
Afati : 2015 – 2017
Donatori: Qeveria Italiane

ANALIZA E PUNËS DREJTORIA TEKNIKE

Drejtoria teknike e D.P.U.K-së përbëhet nga tre sektorë si më poshtë:

- 1- Sektori i Kontrollit të Projekteve dhe Makineri Pajisjeve
- 2- Sektori i Programimit
- 3- Sektori Juridik dhe Prokurimeve

Mbështetur në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizimeve të miratuar me Urdhër të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Nr 93, datë 28.07.2009, kanë ushruar aktivitetin funksional edhe sektorët e Drejtorisë Teknike të D.P.U.K-së për vitin 2014.

1- Sektori i Kontrollit të Projekteve dhe Makineri Pajisjeve.

Sot në arshivën teknike të D.P.U.K-së, ka rreth 595 projekte ujësjetës kanalizime të aplikuara nga Njësitë e qeverisjes vendore apo sh.a Ujësjetës Kanalizime për periudhën janar 2008 e deri më sot nga këto :

I. Projekte vetëm për Ujësjetës, janë 383 copë ku:

- a- Projekte Ujësjetës të plota, sipas Urdhërit, nr 18, datë 30.01.2008, janë 71 copë
- b- Projekte Ujësjetës me vërejtje sipas Urdhërit, nr 18, datë 30.01.2008, janë 312 copë

II. Projekte vetëm për K.U.Z janë 215 copë

- a- Projektet K.U.Z të plota sipas Urdhërit, nr 18, datë 30.01.2008, janë 30 copë
- b- Projektet K.U.Z, me vërejtje sipas Urdhërit, nr 18, datë 30.01.2008, janë 185 copë

Gjatë vitit 2014 kanë ardhur pranë D.P.U.K-së rreth 89 projekte të reja të cilat janë kontrolluar nga sektori përkatës, nga këto 59 copë projekte janë për ujësjetës dhe 30 copë janë për K.U.Z. Gjithashtu ky sektor ka rikontrolluar edhe rreth 111 projekte për të cilët kanë ardhur dokumentacione plotësuese.

Specialisti elektrik pranë këtij sektori ka ndjekur edhe korrespondencën me ndërmarrjet sh.a ujësjetës kanalizime për konsumin e energjisë elektrike për çdo tre mujor.

2. Sektori i Programimit

Ky sektor ka hartuar në kohë detajimin e Plan Buxhetit për vitin 2014, i cili ka ardhur pranë D.P.U.K-së me shkresën e M.T.I-se, nr prot 1089/4, datë 17.03.2014.

Ka hartuar konfrom udhëzimeve përkatëse P.B.A për periudhën (2015 -2017) faza e parë dhe fazen e dytë.

Ka realizuar në kohën e duhur, rialokimet e kërkuara nga kordinatorët e projekteve të huaja si dhe rialokimet për objektet në vazhdim duke ndjekur ecurinë e realizimit të tyre.

Ka hartuar tabelat përkatëse për objektet me financim nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për objektet e filluara në vitet (2012-2013).

Për objektet e reja të vitit 2014 me financim nga F.ZH.R është bërë pikëzimi sipas kriterëve të përcaktuara nga K.ZH.R , janë hartuar pasaportat teknike për çdo objekt.

Gjatë vitit 2014 janë çelur rreth 31 objekte të reja nga Buxheti i Shtetit për të cilat janë hartuar fishat përkatëse dhe tabelat e rialokimeve.

3. Sektori Juridik & Prokurimeve.

- I- Menjëherë me vënien në dispozicion të fondeve buxhetore më datë 17.03.2014, kemi hartuar rregjistrin e prokurimeve, sipas rialokimeve të fondeve janë hartuar edhe regjistrat shtesë, raportimi i realizimit të prokurimeve është bërë brënda afateve kohore të përcaktuara.
- II- Janë realizuar procedurat e tenderimit për objektet si më poshtë:
- 1- Objekti: "Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza Sarandë, derdhja në I.P.U.Z " (shtesë kontrate) Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit dhe kontrata është lidhur më datë 31.07.2014.
 - 2- Supervizion punimesh për objektin: "Ndërtim i kolektorit kryesor të ujërave të zeza Sarandë, derdhja në I.P.U.Z" (shtesë kontrate) Procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit dhe kontrata është lidhur më datë 31.07.2014.
 - 3- Objekti: "Rikonstruksion i ambjenteve të tualeteve dhe zyrave të D.P.U.K-së" Procedura e prokurimit, kërkesë me propozim , procedura elektronike dhe kontrata është lidhur, më datë 26.12.2014.
 - 4- Supervizion punimesh për objektin: "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga pus-shpimet e Çermës, **Loti I:** (Dublimi i pus-shpimeve ekzistuese, rikonstruksioni i Stacionit Qendror dhe ndërtimi i rezervuarit 1000 m3, linjat e ujesjellesit pusshpime - Stacion Qendror, linja e ujesjellesit Çërme-Rrogozhinë pik 426, Rikonstr.linjat elektrike) Procedura e prokurimit , shërbim konsulence , elektronike, kjo procedure është tenderuar tre here dhe ka rezultuar e pasukseshme dhe është anuluar, në datat 18.08.2014, 17.11.2014 dhe 15.12.2014.
 - 5- Për Supervizion punimesh për objektin: "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga pus-shpimet e Çermës, **Loti II:** (Linja e ujesjellësit me presion nga ura e Rrogozhinës piketa 426 deri në pus - ndërprerje Kavajë, pus - ndërprerje Kavajë, linja e Ujesjellësit pus - ndërprerje deri në depon ekzistuese Kavajë) nuk u zhvillua procedura e prokurimit pasi varet nga ecuria e objektit të zbatimit i cili është në proces gjygjësor.
 - 6- Objekti: "Studim projektim i sistemit të K.U.Z, në zonën turistike të Spillesë" nuk u realizua procedura e tenderimit për mungese plotësim dokumentacioni teknik nga ana e Komunës Kryevideh.
 - 7- Objekti: " Studim projektim i sistemit të K.U.Z në zonën turistike të Gjirit të Lalzit" nuk u realizua procedura e tenderimit për mungese dokumentacioni teknik nga ana e Komunës Ishëm.
 - 8- Objekti : " Furnizimi me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fsharave rreth tij (shtesë kontrate)" në fillim ishte autoritet kontraktor Bashkia Kukës , pastaj është bërë autoritet kontraktor D.P.U.K-ja, për këtë objekt është kërkuar një ripunim i plotë teknik nga ana e projektueses e cila për mungesë fondesh projektimi nuk e ka realizuar, prandaj edhe procedura e tenderimit nuk është realizuar.
 - 9- Për objektin: " Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga pus-shpimet e Çermës, **Loti II:** (Linja e ujesjellesit me presion nga ura e Rrogozhinës piketa 426 deri ne pus - nderprerje Kavaje, pus - nderprerjeje Kavaje, linja e Ujesjellesit pus - nderprerje deri ne depon ekzistuese Kavaje) procedura e tenderimit ka filluar në vitin 2012 dhe është në vazhdim në bazë të V.K.M-së, nr 948, datë 26.12.2012, është e pezulluar dhe ndodhet në proëes gjygjësor.
- III- Përsa i përket veprimtarisë në fushën e ligjëshmërisë ky sektor është përqëndruar në funksionimin e saj drej përfaqsimi të institucionit tonë në të gjitha proceset gjygjësore ku kemi qënë palë si paditës dhe të paditur.

Konkretisht jemi në 22 proçese gjygjësore me objekte të ndryshme nga të cilat mund të veçojme 12 proçese me objekt " Dëmshperblim dëmi" dhe 10 proçese me objekt " Kundërshtim V.K.M-je për shpronësimet në projektet e ndryshme që operon institucioni ynë nga të cilat 6 janë ankimuar në Gjykatën e apelit .

Proçese gjygjësore të përfunduara që kanë marrë formë të prerë prej Gjykatës së Apelit janë 2 dhe kane pasur për objekt proçeset e tenderimit të **Lotit I dhe te II** të "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga pus-shpimet e Çermës"

Ndjekja dhe përfaqsimi në çdo gjykatë për çdo proçes gjygjësor duke patur parasysh rëndësinë e proçeseve dhe objekteve për të cilat janë ngritur kërkes paditë marrin rëndësinë e tyre të veçantë dhe prokupimin maksimal të sektorit juridik duke përgatitur , mbledhur dhe paraqitur prova dhe dokumenta ligjore të argumentuara për tu përfaqësuar denjësisht dhe duke synuar rrëzimin e pretendimit të paditësave.

Sekretaria teknike pranë drejtorisë teknike gjatë vitit 2014, ka organizuar mbledhje të këshillit teknik të D.P.U.K- së për objektet si më poshtë:

- 1- Për objektin:"Shqyrtim i projektit të fizibilitetit për venien në funksion të I.T.U.P Vlorë" më datë 12.05.2014.
- 2- Për projektin:" Projekti teknik në kuadër të programit infrastruktura Bashkiake II për qytetin Kamëz" me datë 15.05.2014.
- 3- Për objektin:"Ndërtim i kolektorit kryesor të ujrave të zeza Sarandë, derdhja në I.P.U.Z " (shtesë kontrate) dhe objektin: "Rikonstrukcion ambjeteve te tualeteve dhe zyrave të D.P.U.K.-së", më datë 30.05.2014.
- 4- Për objektin:" Furnizimi me ujë i zonës së plazhit , pjesa majtas dhe djathtas" më datë 29.07.2014.
- 5- Për objektin:" Furnizimi me ujë i plazheve Durrës - Kavajë nga burimet e Çermes, **Loti III:** (Linja e ujesjellesit nga piketa Nr.235, degezim Kavaje deri ne depon e re 4000 m3 Arapaj, ndertim depo e re 4000 m3 Arapaj, Durres)(Kontrate e lidhur) ndryshime në projekt preventivi më datë 18.09.2014.

Gjithashtu sektori i programit në bashkëpunim me sektorin e investimeve kanë ndjekur ndjekur ecurinë e programimeve dhe realizimeve te objekteve për planin buxhetor të vitit 2014,që në pasqyrë të përgjithëshme paraqitet si më poshtë:

I. Fondet e Buxhetit 2014

➤ Plani	në total	3,437,602,689 lekë
➤ Financimi	në total	3,055,566,176 lekë

Kjo vlerë e shprehur në % është realizuar në masën 88.3 %

Ky realizim i shprehur sipas nën kapitujve të vetë buxhetit 2014 kemi:

1. Objekte në vazhdim të çelura gjatë viteve 2012-2013 ku:

➤ Plani	në total	833,666.000 lekë
➤ Financimi	në total	796,848,534 lekë

Kjo shifër e shprehur në % është realizuar në masën 96%

2. Objekte të reja të çelura në vitin 2014(31 objekte):

➤ Plani	në total	3,437,602,689 lekë
➤ Financimi	në total	3,055,566,176 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 80%

3. Studime projektive dhe oponenca teknike

➤ Plani	në total	7,362,000 lekë
➤ Financimi	në total	7,279,700 lekë

Ky fond i shprehur në % është realizuar në masën 99%

II. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

➤ Plani	në total	900,000,000 lekë
➤ Financimi	në total	615,885,779 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 68% dhe i shprehur në nën/kapituj është si më poshtë vijon:

1. Objekte në vazhdim të çelura gjatë viteve 2012-2013 ku:

➤ Plani	në total	424,119,369 lekë
➤ Financimi	në total	386,716,694 lekë

Kjo shifër e shprehur në % është realizuar në masën 91%

2. Shpronësime për pronarët ne bajpasin e unazës së qytetit të Vlorës:

➤ Plani	në total	225,235,631 lekë
➤ Financimi	në total	70,800,216 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 31%

3. Rehabilitimi i rrugëve të Korçës ,sipas VKM-së

➤ Plani	në total	150,377,759 lekë
➤ Financimi	në total	80,000,000 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 53%.

4. Objekte të reja të çelura në vitin 2014 me autoritet kontraktor FSHZH :

➤ Plani	në total	55,947,741 lekë
➤ Financimi	në total	35,601,144 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 64%

5. Objekte të reja të çelura në vitin 2014 me autoritet kontraktor njësitë vendore(bashkitë, komunitat):

➤ Plani	në total	43,767,725 lekë
➤ Financimi	në total	42,767,725 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 98 %

6. TVSH +T.D në vitin 2014:

➤ Plani	në total	1,222,382,655 lekë
➤ Financimi	në total	1,214,172.323 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 99 %

7. Kosto lokale në vitin 2014:

➤ Plani	në total	155,838,000 lekë
➤ Financimi	në total	145,498,867 lekë

Kjo fond i shprehur në % është realizuar në masën 93 %.

Siç shikojmë mosrealizimi i planit buxhetor të investimeve për vitin 2014 vjen nga kapitulli për investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në total në masën 68 % .

Në detajimin e planit buxhetor 2014, është programuar fondi si më sipër 900,000,000 lekë.

Kjo shumë do të likujdonte vlerën e mbetur prej 900,000,000 për 91 objekte në vazhdim, të çelura në vitet 2012-2013, por KZHR nga ky fond planifikoi shumën prej 225,235,631 lekë për shpronësimet e pronarëve për bajpasin e Vlorës që është realizuar në masën 31 % .

Gjithashtu është për t'u theksuar se edhe fondi për objektet e reja në vitin 2014, me autoritet kontraktor Fondit Shqipëtar të Zhvillimit paraqet një realizim të ulët në masën 31 %.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për objekte në vazhdim, plani 424,119,369 lekë është çelur në thesar më datë 12.12.2014, për rreth 50 objekte me shumë vonesë.

ANALIZA E DREJTORISE EKONOMIKE

Analizë e punës së kryer dhe rezultatet e arritura, për periudhën Janar–Dhjetor 2014, sipas sektorëve që mbulon kjo drejtori.

a. Sektori i Financës.

b. Sektori i investimeve.

c. Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

Në ballafaqim me detyrat e caktuara nënregulloren e brendeshme, në funksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetillës Kanalizimeve, Drejtoria Ekonomike për periudhën janar-dhjetor 2014 është përqëndruar dhe ka kryer detyrat si më poshtë:

Sektori i Financës

Ky sektor është përqëndruar në ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit të brendshëm të DPUK-së duke raportuar dhe mbajtur në kontroll zbatimin e kriterëve ligjorë dhe të kontabilitetit financiar, duke kontabilizuar çdo artikull sipas faturës përkatëse. Për këtë qëllim ky sektor ka bërë programimin për ndjekjen e fondeve sipas planit të detajuar dhe të realizuar në çdo muaj të vitit sipas buxhetit të vitit 2014.

Janë ndjekur dhe financuar gjithë kontratat ku investitor ka qenë DPUK-ja, si për studim projektimet, rimbursimet për TVSH-në, TD, kosto lokale, dhe subvencionet për ndërmarrjet e ujësjetillave dhe komunave.

Janë ulur në mënyrë të ndjeshme në masën 110.9 milion lekë detyrimet e prapambetura, sipas udhëzimit Nr. 5 të Ministrisë së Financave, me ndihmën dhe të autoritetit të MTI-së dhe MF-së për tvsh-në e projektit të rrethit Bilisht dhe të detyrimit të prapambetur të vitit 2013 të projektit të "Spiges" e tjera, detyrim i cili nga 227 milion në fund të vitit 2013 u zvogëlua në masën 116.2 milion lekë.

Po punohet me përkushtim nga sektori i financës dhe sektoret e tjerë për dorëzimin në kohë të bilancit kontabël, të rakorduar me pasqyrat financiare përkatëse të firmosura nga Dega e Thesarrit, Tiranë.

I-Shpenzimet Korente.

Paga. Plani vjetor ishte 40 milion lekë. Realizimi faktik i Art. 600 për periudhën Janar-Dhjetor 2014 është 33.8 milion lekë.

Numri i miratuar i punonjësve është 35 + 2 (Punonjës me kohë të reduktuar).

Sigurime Shogërore. Plani vjetor 8 milion lekë. Realizimi faktik për periudhën Janar-Dhjetor 2014 për Art. 601 është 5.25 milion lekë.

Mallra dhe Shërbime të tjera. Plani vjetor 12.5 milion lekë. Realizimi faktik për periudhën Janar-Dhjetor 2014 është 8.9 milion lekë. Ky fond është përdorur sipas detajimit mujor të miratuar me shkresë të MTI-së nr.288 Prot., datë 22.01.2014, si dhe të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për Art.602 miratuar nga MTI me shkresën 936/1 Prot., datë 03.03.2014.

Transferta. Plani 78 mijë lekë. Realizimi faktik 72 mijë leke.

Subvencione. Plani vjetor 450 milion lekë. Realizimi faktik për periudhën Janar-Dhjetor 2014 është 450 milion lekë. Fondi i akorduar, nga DPUK-ja është përdorur në zbatim të Udhëzimit nr.6569, datë 27.06.2006 "Për Kriteret e Procedurave për Përdorimin e Subvencioneve Shtetërore për Sh.A dhe Ndërmarrjet e Ujësjetillës Kanalizimeve".

Shuma e shpenzimeve Korente të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2014 është 498 milion lekë.

II. Shpenzime Kapitale.

Kapitale të patrupëzuara Studim Projektme. Plani vjetor me ndryshime ishte 10.1 milion lekë. Realizimi faktik Janar-Dhjetor 2014 është 7.28 milion lekë.

Kapitale të Trupëzuara. (Investime TVSH +TD dhe Kosto Lokale). Plani vjetor me ndryshime 1.497 miliard lekë.

Kapitale të Trupëzuara është si më poshtë:

Investime ujësjellës kanalizime, planifikuar 284.1 milion lekë, realizuar 265.2 milion lekë, e shprehur në përqindje 93.4%.

Kosto Lokale planifikuar 28.9 milion lekë, realizuar 24.7 milion lekë, e shprehur në përqindje 85.4%.

TVSH dhe Takse Doganore planifikuar me gjithë ndryshimet e bëra 1.184 miliard lekë, realizuar 1.134 miliard lekë, e shprehur në përqindje 95.8%.

Artikulli subvencione në shumën 450 milion lekë planifikuar, është shpërndarë në Rajonet e Ujësjellës Kanalizimeve dhe komunave sipas një plani të detajuar nga sektori i buxhetit, i rakorduar me degët e thesarit në rrethet përkatëse po në shumën 450 milion lekë.

Shuma e shpenzimeve kapitale faktike për periudhën Janar-Dhjetor 2014 ishte 1.431 miliard lekë.

Shuma e shpenzimeve korente dhe kapitale të planifikuara dhe ato të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2014, për Drejtorinë Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve bashkë me subvencionet është 2.018 miliard lekë, kundrejt 1.929 miliard lekë bashkë me subvencionin e shpërndarë nga degët e thesareve në rrethe. Këto shpenzime janë të konfirmuara nga Dega e thesarit Tiranë.

Shpenzimet në valutë për periudhën Janar-Dhjetor 2014, për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve janë 269 Euro. (shpenzime dieta me jashtë vendit për pjesëmarrjen në takimin për miratimin përfundimtar, për projektet e detajuara teknike dhe për dokumentacionet e prokurimit për programin "Infrastruktura Bashkiake I dhe II".)

Sektori i Investimeve.

Prioriteti i sektorit të investimeve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014 ka qënë ndjekja e kontratave të lidhura me kontraktorët me dokumentacionin përkatës, gjithmonë me fondet e DPUK-së sipas planit tëshprehur me lartë në shumën 284.1 milion lekë dhe të realizuar në shumën 265.2 milion lekë, e shprehur në përqindje 93.4%.

Gjatë vitit 2014 për kontratat ku autoritet kontraktor është DPUK-ja janë përfunduar objektet si më poshtë:

Furnizimi me ujë i qytetit të Pukës, rrjeti i jashtëm dhe rrjeti i brëndshëm.

Ndërtimi i ujësjellësit rajonal Novosej-Shishtavec-Borje, komuna Shishtavec, Kukës.

Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujerave të zeza Sarandë, derdhja në IPUZ (shtesë kontrate).

Objektet e mësipërme janë kolauduar e dorëzuar përfituesve të tyre, Bashkive, Komunave, ose SH.a. Ujësjellësave.

Për kontratat ku autoritet kontraktor është DPUK-ja, realizimi i tyre paraqitet si më poshtë:

1. Për objektin "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga Pus Shpimet e Çermës, Lot.I", është lidhur kontrata me sipërmarresin e punimeve, por nuk kanë filluar punimet pasi nuk është përzgjedhur mbikqyrësi i punimeve.

2. Për objektin "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga Pus Shpimet e Çermës, Lot.II", nuk është lidhur kontrata, pasi nuk ka përfunduar procedura e prokurimit të këtij objekti.

3. Për objektin "Furnizimi me ujë i plazheve Durrës-Kavajë nga Pus Shpimet e Çermës, Lot.III", kanë filluar punimet për ndërtimin e depos së re b/arme 4000 m3 në Arapaj. Janë realizuar 107 milion lekë, ose rreth 10% e punimeve sipas kontratës, pasi ka patur pengesa lidhur me lejën e infrastrukturës, shpronësimet dhe lirimimin e sheshit të ndërtimit, gjithashtu ka patur dhe probleme projekti.

4. Për objektin "Përfundimi rrjetit të KUZ në zonën e përroit të Agait-Qerret, Lot.I", janë realizuar 233.7 milion lekë ose rreth 86% e punimeve sipas projektit.

Për realizimin e këtij objekti do të nevojiten fonde shtesë, pasi ka zona të pa përfshira në projekt, për këtë qëllim nga kontraktori dhe mbikqyresi i punimeve po azhurnohet gjendja dhe po përgatitet materiali teknik përkatës.

5. Për objektin "Përfundimi i rrjetit të KUZ në zonën e Perroit të Agait-Qerret, Lot II", nuk kanë filluar punimet, pasi kontraktori me të cilën është nënshkruar kontrata është tërhequr nga realizimi i saj, dhe çështja e prishjes së kontratës është në proces gjyqësor.

6. Objekti "Rikonstruksion i ambienteve të tualeteve dhe zyrave të DPUK-se", nuk ka përfunduar procedura e tenderimit, për këtë arsye nuk kanë filluar punimet.

Për kontratat ku autoritet kontrator është DPUK-ja në shumë objekte ka patur probleme lidhur me cilësinë e projekteve dhe preventivave të hartuara nga subjektet projektuese, këto probleme kanë dalë gjatë fazës së implementimit dhe zbatimit të këtyre projekteve.

Për afatet e realizimit të kontratatve, kemi patur shqetësime lidhur me realizimin e afateve të përfundimit të objekteve.

Në kontrata janë përcaktuar afatet e përfundimit të objekteve, ndërkohe kur burimet e financimit kanë qënë të pjesshme, në përgjithësi konstatojme se nuk po zbatohen afatet kontraktuale të kontratatve.

Sugjerojmë që në momentin e hartimit të kontratatve, të shikohet mundësia e përpunimit të kontratatve dhe afatet të vihen në përputhje me fondet që janë të disponueshme (fonde e programuara), pasi përfundimi i objekteve krahas masave tekniko-organizative të kontraktorit të punimeve, varet edhe nga celja e fondeve të nevojshme.

Gjatë vitit 2014 Sektori i Investimeve ka ndjekur në vazhdimësi edhe realizimin e investimeve të buxhetit të fondit të zhvillimit të rajoneve, kjo në bashkëpunim me autoritet kontraktore në shkallë vendi. Por gjatë ndjekjes së investimeve është konstatuar se shumë komuna e bashki të vendit, që janë në rolin e autoritetit kontraktor nuk japin rregullisht dhe në kohë informacionin e nevojshëm, ose të dhënat që japin nuk janë të sakta. Kjo bëhet pengesë për raportimin në kohë nga ana jonë të evidencës që dërgojmë në Ministri në rrugë elektronike dhe në atë shkresore.

Disa herë gjatë vitit janë dërguar shkresa të gjithë autoriteteve kontraktore mbi raportimin në kohë të evidencës së realizimit të investimeve për ujësjellës-kanalizime, sipas buxhetit të vitit 2014.

Megjithë vështirësitë për grumbullimin e të dhënave, nga ana jonë janë përpunuar dhe është nxjerrë evidenca e realizimit të investimeve cdo muaj dhe duke e raportuar në Ministri.

Sektori i Burimeve Njërzore dhe Shërbimeve.

Sektori i Burimeve Njërzore dhe Shërbimeve ka arritur të shqyrtojë dhe të realizojë me sukses një sërë problematikash në fusha të ndryshme si zbatimin e organigramës së miratuar, trajtimin e procedurave të plotësimit dhe përmirësimin e pajisjeve të punës, kujdesit dhe mbarevajtjes për shërbimet e ndryshme, problemet e sigurimit, protokollimit dhe arshivimin, postën, mirëmbajtjen e ndërtesës, zyrat etj.

Është mbajtur me korektësi evidenca për regjistrimet personale të cilat përfshijnë të dhënat dhe informacionin e duhur lidhur me personelin e DPUK-së.

Është përgatitur dhe ndjekur në vazhdimësi dokumentacioni për listeprezencat dhe pushimet vjetore, duke respektuar grafikun e kësaj të fundit.

Ka ndjekur dhe realizuar zbatimin e politikave për të drejtat dhe detyrat që kanë punonjësit ndaj shtetit, në funksion edhe të raportit të pagave të punonjësive sipas strukture së DPUK-së.

Ka ndjekur, përgatitur, verifikuar rregullat e përgjithshme të zbatimit të rregullores në punë, si edhe kriteret e nevojshme për zbatimin e disiplinës në punë dhe masat e mara sipas rastit.

Ka bërë regjistrimin dhe shpërndarjen e cdo dokumenti që ka ardhur në DPUK, të konfirmuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe më pas ju është dhënë drejtorive përkatëse.

Është arshivuar me proces-verbal i gjithë dokumentacioni me fletë inventari nga personat e autorizuar të DPUK-së.

Janë ndjekur dhe kontrolluar sipas urdhërave të Drejtorit të Përgjithshëm shërbimet e punonjësve brenda shtetit dhe jashtë tij.

Janë njohur të gjithë punonjësit e DPUK-së me legjislacionin, aktet ligjore dhe nënligjore me specifikat perkatese për tu bërë sa më praktike dhe eficiente në zbatimin e tyre.

Janë shqyrtuar dhe dhënë mendime për aktet që vijnë nga institucione të tjera në fusha të ndryshme të legjislacionit.

Sektori i Burimeve Njerezore dhe i Shërbimeve është njohur më nga afër me statusin e nëpunësit civil e shprehur në Ligjin 152/2013, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në datë 30 maj 2013, i cili ka sjellë ndryshime në menaxhimin e sektorit të burimeve njerëzore.

Jemi njohur me një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave që nga ata që përfitojnë statusin e nëpunësit civil dhe procedurat e rekrutimit, administrimit e dosjeve të punonjësve, miratimin e Rregullave të Organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse e tjera.

Jemi në përfundim të hartimit të dy rregulloreve të brendshme, një ajo e parandalimit dhe konfliktit të interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike në DPUK dhe tjetra për etikën në DPUK, detyrë e lënë dhe nga KLSH.

Trainimet lënë për të dëshiruar pasi janë bërë sporadike dhe nuk kanë qenë të mirefillta për sektorët që mbulojmë.

OBJEKTIVAT DHE DETYRAT PËR VITIN 2015 NË BAZË TË ANALIZËS SË REZULTATEVE TË VITI 2014.

Pas analizës që i bëri punës, në shkallë drejtorie dhe sektori për periudhën Janar-Dhjetor 2014, Drejtoria Ekonomike e DPUK-së konstaton se për periudhën e kryerjes së analizës, kjo drejtori ka bërë përpjekje për arritjen e objektivave që ka në përgjithësi kjo drejtori, si në atë të ndjekjes së problemeve në aspektin financiar, të investimeve dhe në ato të burimeve njerëzore. Sektorët e kësaj drejtorie si specialiste dhe drejtues kanë qenë në krye të detyrës dhe me predispozicion të plotë. Konstatohet se puna e kësaj drejtorie ka arritur në rritje. Kërkesa e llogarisë, kryerja e punëve në grup, bashkëpunimi me drejtoritë e tjera, analizat periodike me qëllim konstatimin dhe përmirësimin e temetikave në kohë, kanë qenë disa nga masat që kanë cuar në përmirësim të punës.

Për periudhën në vazhdim, do të përqëndrojmë punën në këto drejtime:

Në sektorin e Financës puna do të përqëndrohet :

Dotë përmirësojmë organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë së Drejtorisë Ekonomike në fushën e menaxhimit financiar të fondeve për investimet publike dhe ato të brendshme nëpërmjet:

Zbatimit më me korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e financës dhe të kontabilitetit.

Zbatimit me rigorozitet të procedurave të likuidimit të fondeve të dhëna për investimet.

Plotësimin e saktë të dokumentacionit, bazuar në një kontroll të rreptë, mbështetur në kontratat dhe specifikimet e autoritetit kontrator.

Mbajtja e kontabilitetit të DPUK-së, inventarizimin e mjeteve themelore, dhe nxjerrjen në kohë të bilancit financiar të rakorduar për aktivitetin ekonomik të këtij institucioni.

Analiza e shpenzimeve të planifikuara, duke e rakorduar me MTI, Degën e Thesarit, Tiranë për gjithë treguesit e buxhetit, për të reflektuar përmirësimet në projekt buxhetin e vitit 2015.

Në sektorin investimeve, puna dotë përqëndrohet:

Në përmirësimin e punës në drejtim të saktësisimit, marrjes në kohë të informacioneve për realizimin e investimeve, nga autoritet kontratore, pushteti vendor, për të pasqyruar gjëndjen në kohe reale të realizimit të projekteve dhe në bazë të ecurisë të bëhen propozimet përkatëse, për shtimin ose pakësimin e fondeve në funksion të realizimit.

Në kordinimin më të mirë me Drejtorinë Teknike, në ndjekje të planit të investimeve, kontrollin e tyre, studimin e problemeve gjatë zbatimit, për një menaxhim sa më të mirë të mundshëm.

Raportim në kohë dhe të saktë të realizimeve të investimeve në Drejtoritë përkatëse të MTI-së.

Përmirësim dhe kontroll të ecurisë së disbursimeve nga DPUK-ja dhe pushteti vendor në realizimin e TVSH, Taksat Doganore dhe Kostot Lokale.

Studim të ecurisë së realizimeve dhe propozime për përfundimin e projekteve me vlerë të plotë nëpërmjet rialokimit të fondeve.

Do të punohet më me vendosmëri që të eliminohen defektet e mospërputhjes midis raportimit të realizimit të volumeve fizike dhe financimit të tyre.

Spektori dotë mbajë dosje për cdo projekt, dhe të përmirësojë cilësinë e përgatitjes së materialeve dhe kontrollin në financimin e punimeve të kryera sipas objekteve ku Autoritet Kontrator është DPUK-ja.

Do hartohen dhe mbahen me saktësi listat e objekteve që kërkojnë fonde shtesë nga Autoritet Kontratore që financohen nga buxheti i shtetit dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Teknike, të propozojë planifikimin e këtyre fondeve.

Në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, puna do të përqëndrohet:

Në plotësimin emetueshëm të dokumentacionit të personelit, hartimin e plotë të regjistrit themeltar, sipas udhëzimeve të dhëna nga DAP për të gjithë punonjësit e DPUK-së.

Kontrollin rigoro të kryerjes së detyrimeve të personelit në përputhje me rregulloren e brendshme të DPUK-së.

Në plotësimin e kushteve të punës, lajmerim levizjesh, masat disiplinore, ndjekjet e procedurave ligjore në bashkëpunim me sektorin juridik në lidhje me kodin e punës si dhe kryerjen e rregullt të shërbimeve të brendshme.

Ndjekje të problemeve të legjislacionit, që kanë të bëjnë me pagat, të drejtat dhe detyrimet, kualifikimet të personelit të DPUK-së.

Në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ambienteve të DPUK-së, të dokumentacionit të këtij institucioni që është i akomoduar edhe në zyrat sipas sektoreve, si dhe e të gjitha materialeve që janë në përdorim.

Kujdes të vecantë do të tregohet për korespondencën me MTI-ne dhe DAP-in për shkresat dhe udhëzimet e herëpashershme në adresë të DPUK-së për kthim përgjigje në afatet e caktuar në mënyrë elektronike apo dhe atë shkresore.

Si përfundim mund të themi se këto ishin problemet që dolën në analizën si drejtori dhe në bazë të tyre u bë programimi, për të parë më me përparësi problematikat e përmendura më lart, dhe në aktivitetin e përditëshëm do të merren parasysh dhe përmirësohen ato mangësi që janë vërejtur, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014.

Jemi në pritje të analizës vjetore me pjesëmarrje të gjithë drejtorive të DPUK-së, detyrat e parashikuara dhe që do të na dalin në të ardhmen nga Drejtori i Përgjithshëm, vlerësimin për punën e bërë nga të gjitha Drejtoritë dhe sektoret e këtij institucioni. Gjatë vitit 2015 duhet të kemi një mobilizim më të madh forcash, për të realizuar gjithë treguesit tekniko- ekonomike në nivelet që kërkojnë nga institucioni jonë dhe dikasteri përkatës MTI-ja.

DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA DHE SH.A.UK "BENCHMARKING"

Drejtoria e Monitorimit, ka për detyrë të marrë informacion nga të gjitha njësitet e zbatimit të projekteve dhe shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve të përfshira në programin e monitorimit, në funksion të përmbushjes së objektivave të monitorimit, për sa i përket realizimit të investimeve me financim të huaj, si dhe monitorimit të performancës së çdo shoqërie që zhvillon aktivitetin e furnizimit me ujë e kanalizimeve në Shqipëri, apo performancës së sektorit në tërësi.

Kjo drejtori për bëhet nga dy sektorë:

- Sektori i monitorimit të projekteve të huaja;
- Sektori i monitorimit të sh.a. UK/ Benchmarking

SEKTORI I MONITORIMIT TË PROJEKTEVE ME DONATORË TË HUAJ DHE FAQES SË INTERNETIT

Ky Sektor e ka të organizuar punën dhe aktivitetin e vet të fokusuar në dy drejtime:

- a) Plotësimi i detyrave funksionale në zbatim të rregullores së DPUK-së;
- b) Aktivitete dhe detyra ku stafi i Sektorit të Projekteve të Huaja ka patur rol bashkëpunues dhe asistues në raport me Drejtoritë e tjera të DPUK.

Aktivitetet dhe detyrat kryesore të sektorit realizuar gjatë vitit 2014:

Gjatë vitit 2014 janë monitoruar 23 projekte me financim të huaj

- Është monitoruar situata dhe është përgatitur informacioni mujor mbi realizimin progresiv financiar të projekteve me financim të huaj, ecurinë fizike të punimeve dhe problematikën e evidentuar nga koordinatorët e secilës Njësi zbatuese projekti. Nga monitorimi i të dhënave për vitin 2014 rezulton se plani për financimin e huaj **prej 8.3 miliard lekësh është realizuar në vlerën 7.3 miliard lekë ose në masën 88%.**
- Janë bërë të gjitha përpjekjet për të Raportuar në Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve dhe Integritetit pranë MTI, në përputhje me afatet e përcaktuara, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, sipas tabelës përmbledhëse, matricës dhe formularit nr. 5.
- Gjatë vitit 2014 është punuar për konsolidimin dhe përditësimin e një bazë të dhënash për investimet sipas burimit të financimit (buxhet i shtetit/donatorët), destinacionit (ujësjellës-kanalizime-impianete trajtimi) edhe me bazë qarkun, të detajuar më tej sipas shoqërive apo njësive vendore për periudhën 2005-2014.
- Janë përgatitur fishat me informacion për secilin nga projektet e reja me donatorë të huaj sipas formularit përkatës, të cilat janë dërguar pranë Drejtorisë së Planifikimit Financiar dhe Statistikave në MTI.
- Në bazë të monitorimit në vazhdimësi të ecurisë financiare dhe fizike të projekteve si dhe përdorimit me efikasitet të fondeve të vëna në dispozicion, në bashkëpunim me sektorin e programimit është kryer rialokimi i fondeve për TVSH dhe Kosto lokale. Për vitin buxhetor 2015 në bashkëpunim me Njësitë e zbatimit të projekteve fondet për TVSH dhe KL janë planifikuar në vlerat: TVSH 1,2 miliard lekë dhe 0,4 miliard lekë Kosto Lokale.

- Është kryer raportimi periodik i monitorimit financiar dhe fizik për projektet me financim të huaj sipas formularëve tip të hartuar nga Ministria e Ekonomisë (formularët 1,2,3), në datë 6 të çdo muaji.
- Është kryer në mënyrë korrekte përditësimi i informacionit elektronik pranë kabinetit të ministrit mbi ecurinë fizike e financiare të projekteve FH dhe problematikat e hasura gjatë procesit të zbatimit të tyre (Hedhja në drop box e matricës së realizimit fizik dhe financiar për çdo projekt).
- Është raportuar çdo javë pranë Kabinetit të Ministrit për situatën e furnizimit me ujë në zonën turistike gjatë sezonit veror 2014. Përgjithësisht gjatë monitorimit ka rezultuar një situatë e kënaqshme e furnizimit me ujë të këtyre zonave me përjashtim të disa rasteve të avarive teknike ku DPUK është angazhuar për evidentimin dhe zgjidhjen sa më parë të problemit.
- Është përditësuar faqja e internetit me informacione mbi gjendjen aktuale të sektorit, të dhënat e treguesit e performancës për çdo shoqëri UK dhe sektorin në tërësi, Projektet e investimeve që janë duke u kryer në këtë sektor, perspektivën etj.
- Gjatë vitit 2014 janë ndjekur dhe zbatuar detyra të tjera që kanë të bëjnë me prokurimet me vlerë të vogël apo korespondenca ditore.
- Duke ju referuar kërkesave për investime në sektorin e Ujësjetës – Kanalizime janë planifikuar në projektbuxhetin e vitit 2015, investime për projekte të reja dhe ato në vazhdim me vlerën 11.3 miliard lekë. Projektet e reja të përfshira në planifikimin e vitit 2015 dhe që do të fillojnë zbatimin e tyre janë:
 1. Programi i Infrastrukturës Bashkiake III dhe IV
 2. Makineri pajisje për ITUP Velipojë faza e III, IPA 2011
 3. Furnizimi me ujë i qytetit të Peshkopisë, financim i qeverisë Austriake
 4. Përfundimi i sistemit të KUZ dhe zgjerimi i ITUP në Vlorë IPA 2012

SEKTORI I MONITORIMIT & BENCHMARKING

1. DETYRAT DHE AKTIVITETET E KRYERA GJATË VITIT 2014

Sektori i Monitorimit të shoqërive UK dhe Benchmarking gjatë vitit 2014 ka realizuar të gjitha detyrat sipas përcaktimit të bërë në manualin e operimit, si dhe në rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizimeve, ku përmbledhtas do të veçoj:

- Grumbullimin e pyetësorëve të tremujorit të katërt të vitit 2013 dhe përgatitja e analizës së performancës së sektorit për vitin 2013.
- Grumbullimin, regjistrimin dhe korrektimin e të dhënave sipas tremujoreve (1,2 dhe 3) të vitit 2014.
- Analiza e të dhënave dhe treguesve të performancës për 56 shoqëritë UK të përfshira në programin e monitorimit për 6 dhe 9- mujin e vitit 2014.
- Analizën e hollësishme të anomalive për të dhënat e vitit 2014.

Brenda këtyre katër pikave përmbledhet një volum shumë i madh punë që përbën edhe thelbin e punës së këtij sektori.

- Stafi i Njesisë së Monitorimit, ka përgatitur një sërë raportesh mbi performancën e çdo shoqërie apo dhe sektorit në tërësi.
- Një Analizë e hollësishme e treguesve kryesorë të performancës për 6/mujin e parë të vitit 2014, i është dërguar:

- Të gjitha Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Këshillave Mbikqyrëse të Sh.a.-ve, për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve UK;
- Shoqërive të Ujësjetllës Kanalizimeve me qëllim përmirësimin e performancës së tyre;
- **Ministritë së Transportit dhe Infrastrukturrës** për të përmirësuar vendim marrjen në fushën e ujësjetllës kanalizimeve, në funksion të mbështetjes së procesit të hartimit të reformës sektoriale.
- Përveç raporteve të monitorimit dhe pasqyrave me të dhëna e tregues, stafi i Njesisë së Monitorimit ka kontribuar, me opinionin e vet profesional në lidhje me mënyrat se si mund të menxhohen më mirë sistemet e ujësjetllës.
- Pjesëmarrja në grupet e punës brenda DPUK, MTI si dhe institucione të tjera, ka qenë një proces i vazhdueshëm i punës së këtij sektori.

Gjithashtu gjatë vitit 2014 janë realizuar edhe një sërë aktivitete e detyra të tjera shumë të rëndësishme ndër të cilat do të veçoj:

Monitorimin e strategjisë

DPUK dhe Njësia e Monitorimit si pjesë përbërëse e saj, kanë rol shumë të rëndësishëm për vlerësimin e performancës së sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe për monitorimin e objektivave strategjike, shprehur ato nëpërmjet treguesve të performancës. Ky proces është i vazhdueshëm prandaj dhe analiza e të dhënave e treguesve është pjesë e këtij procesi.

Hartimi i bilancit financiar për sektorin UK për vitin ushtrimor 2013

Gjatë tremujorit të dytë 2014, u grumbulluan bilancet financiare të vitit 2013 nga të gjitha shoqëritë ujësjetllës kanalizime dhe është bërë regjistrimi i të dhënave të pasqyrave financiare të tyre në databazën e përgatitur nga Njësia e Monitorimit. Nga 56 shoqëritë e monitoruara janë vetëm 3 shoqëri (Tropoja, Shkodër qytet dhe Fush-Arrëz), që nuk i kanë sjellë akoma bilancet e vitit 2013.

Bazuar në të dhënat e bilanceve financiare të vitit 2013, krahasuar edhe me ato të programit të monitorimit për të njëjtën periudhë u analizua me shumë detaje e përgjegjësi, **elementi i kostos "amortizim"**. Njësia e Monitorimit për të qartësuar dhe saktësuar të dhënat që kanë të bëjnë me këtë element të kostos, i cili përbën 20% të kostos totale Ujësjetllës Kanalizime, organizoi dhe zhvilloi një seminar me stafin e financierëve të të gjitha shoqërive të monitoruara.

Seminari u zhvillua duke i ndarë shoqëritë në tre grupe përkatësisht në datat 27,28 dhe 29 Maj 2014. Në analizë u morën të gjitha shoqëritë veçmas, duke tërhequr vëmendjen për parregullsitë e secilës, për mënyrën e llogaritjes së amortizimit dhe pasqyrimit të tij në bilanc si dhe në pyetësin që i shërben procesit të monitorimit.

Vlerësimi i detyrimeve të ndërsjetllta debitore

Përveç amortizimit, nga analiza e bilanceve financiare në nivel sektori, rezultoi se detyrimet që Shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve kanë kundrejt të tretëve arrijnë vlerën **6.9 miliard lekë** (detyrime për faturat e energjisë, materiale, sigurime shoqërore, shëndetësore tatim taksa, TVSH etj) ndërsa detyrimet që të tretët kanë kundrejt shoqërisë për fatura të papaguara të ujit e detyrime të tjera, rezultojnë në vlerën **7.4 miliard lekë**.

- Nga vlerësimi i të dhënave të monitorimit për 9 mujorin 2014, shumat e detyrimeve debitore për fatura të pa paguara për ujin e kanalizimet rezultojnë rreth 800 milion lekë.
- Kosto e lartë e energjisë elektrike ka bërë që DPUK të punojë edhe në drejtim të vlerësimit të detyrimeve, që Shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve kanë për faturat e pa paguara të energjisë elektrike të cilat deri në fund të shtatorit 2014 rezultojnë 2.4 miliard lekë;

Detajimi i Subvencioneve

Plani i subvencioneve për vitin 2014 është 450 milion lekë. Në bazë të analizës së bërë për çdo Shoqëri Ujësjetllës Kanalizime është bërë detajimi dhe shpërndarja e subvencioneve për shumën

441 milion lekë për Shoqëritë UK dhe 9 milion lekë për disa komuna që kishin sjellë informacionin e duhur.

Shpërndarja e subvencioneve u realizua në përputhje me udhëzimin e përbashkët nr. 6569 datë 12.07.2006 "Për kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së subvencioneve....."

Inspektimet në terren

Bazuar në rezultatet e monitorimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 dhe analizës së tyre, u hartua kalendar i dhe u zhvilluan inspektime në 20 Shoqëritë e UK të cilat kishin raport shumë të ulët të mbulimit të kostos me të ardhurat apo që të dhënat e tyre nuk ishin shumë të besueshme.

Gjatë vitit 2014 stafi i Njesisë së Monitorimit,

- Ka marrë pjesë në koferenca e aktivitete të ndryshme që janë zhvilluar në sektor, me qëllim rritjeje e kapaciteteve menaxhuese.
- Është punuar ngushtësisht me grupet e konsulentëve në sektor për përmirësimin e procesit të monitorimit.
- Është ndjekur korespondenca ditore duke ndihmuar për të dhënë zgjidhje problemeve dhe shqetësimeve të shoqërive por shumë herë edhe të qytetarëve.
- Ka bashkëpunuar me Sekretariatit e Këshillit Kombëtar të Ujit duke e mbështetur atë me informacion të detajuar në lidhje me burimet ujore që aktualisht shfrytëzohen nga Shoqëritë e Ujësjellësit për ujë të pijshëm.
- Stafi i Drejtorisë së Monitorimit dhe asaj Teknike, ka marrë pjesë në të gjitha inspektimet e kryera në 28 fshatrat e zonës turistike Vlorë-Sarandë, program pune në zbatim të urdhërit të Kryeministrit, me qëllim identifikimin e nevojave për investime në këtë zonë, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve ujësjellës-kanalizime.

Janë realizuar edhe shumë detyra që nuk po i përmendim por mendoj se është e rëndësishme, që nëpërmjet një prezantimi të shkurtër të njihemi me situatën e furnizimit me ujë e kanalizime për vitin 2014.

2. DETYRA DHË AKTIVITETE TË PARASHIKUAR PËR VITIN 2015

Për sektorin e monitorimit të projekteve:

- Monitorimi në vazhdimësi, me cilësi dhe në përputhje me afatet kohore sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore e nënligjore, me qëllim evidentimin e ecurisë dhe problematikës gjatë procesit të zbatimit të projekteve me financim të huaj.
- Pjesëmarrja në trajnimin që do të zhvillojë ME për përdorimin e softit të detajuar të monitorimit të investimeve. Në bashkëpunim me ME, MTI dhe Njësitë e Zbatimit të Projekteve, do kërkojmë që të sigurojmë mënyra më efikase për një monitorim sa më të detajuar të Investimeve në sektorin e Ujësjellës - Kanalizime.
- Hartimi i faqes së re zyrtare të internetit për DPUK-në, e cila do të mundësojë akses të shpejtë e shumë më të plotë, jo vetëm për të interesuarit për informacion por edhe për shoqëritë e UK, të cilat në kuadër të programit të ri të monitorimit do të raportojnë on-line.

Për sektorin e monitorimit të Sh.a.UK dhe Benchmarking:

- Monitorimi i sektorit në vazhdimësi, forcimi dhe rritja e cilësisë së këtij procesi nëpërmjet zgjerimit të bazës së të dhënave me informacion për impiantet e trajtimit dhe rritjes së nivelit të besueshmërisë së të dhënave.
- Përgatitja e raporteve dhe informacioneve pas daljes së rezultateve vjetore dhe organizimi e zhvillimi i analizës së sektorit për vitin 2014, me një bazë sa më të gjërë pjesëmarrësish.

- Përpjekje për hartimin e një udhëzimi për shpërndarjen e subvencioneve me një koncept të ri duke drejtuar ndihmën e shtetit tek shtresat e varfra e jo për mbulimin e difiçitit si rezultat i keqmenaxhimit të shërbimeve. Krijimi një baze të dhënash për këtë qëllim.
- Përgatitja e materialeve për përditësimin e informacionit në faqen e internetit.
- Zbatimi i planeve të veprimit dhe i masave për monitorimin e strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe hartimi i informacioneve të nevojshme në mbështetje të reformës sektoriale.
- Hartimi i propozimeve konkrete për akte nënligjore të cilat mundësojnë krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm për menaxhimin dhe monitorimin me efikasitet të shërbimeve UK.
- Realizimi i të gjitha detyrave të tjera që mund të dalin gjatë vitit.

ANALIZË PËR PROJEKTET ME FINANCIM TË HUAJ

PROJEKTE FINANCUAR NGA KFW

1. Programi i Infrastrukturës Komunale I - në Qytetet Fier, Gjirokastrë, Sarandë, Lezhë
Vlera: 30,621,500 Euro; 16,000,000 Euro (kredi) e bute nga KFW, 4,621,500 Euro (Grant) nga Bashkimi Europian dhe 10,000,000 Euro (Grant) nga Qeveria e Zvicres (SECO)

Afati: 2011-2016

Donatori: KFW, Bashkimi Europian (BE), Qeveria Zviceriane

Objektivat:

Në kuadër të programit është parashikuar të rehabilitohen sistemet e ujësjellës kanalizimeve për qytetet Lezhë, Fier, Sarandë, Gjirokastrë me qëllim përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë, sanitetit si dhe rritjen e performancës së Ndërmarrjeve të Ujësllës Kanalizimeve që operojnë këto sisteme. Roli i DPUK-së është "Përgjegjës Programi" dhe roli i Ndërmarrjeve të Ujësllës Kanalizimeve është "Përgjegjës Projekti". Në kuadër të Programit nga DPUK janë kontraktuar "Konsulentit Institucional" dhe "Konsulentit i Zbatimit", secili përgjegjës për aktivitetet në të gjitha Ndërmarrjet e Ujësllës Kanalizimeve që janë pjesë e Programit. Nga Ndërmarrjet e Ujësllës Kanalizimeve kontraktohen "Kontraktorët e punimeve".

Komponenti Institucional:

Në datën 22.07.2011 është firmosur kontrata me konsulentin institucional dhe ka hyrë në fuqi në datën 23.08.2011. Në konceptin e programit, për secilën nga Ndërmarrjet e Ujësllës Kanalizimeve janë vendosur disa kushte paraprake për tu plotësuar, siç është mbulimi i kostove të operimit, përpara se të fillojnë investimet kapitale. Nga verifikimi i situatës nëpërmjet "Konsulentit Institucional" rezulton se ndërmarrjet Fier, Lezhë, Sarandë dhe Gjirokastrë kishin probleme në përmbushjen e kushteve. DPUK në bashkëpunim me konsulentin përcaktuan veprimet konkrete për të përmirësuar situatën. U përgatitën plani i biznesit ku përfshihet edhe studimi i tarifave për të katër ndërmarrjet për të katër qytetet. Gjithashtu për qytetin e Sarandës është studiuar nga konsulentit problemi i marrëdhënieve me katër komunat që furnizohen nga sistemi dhe është finalizuar marrëveshja ku përfundimisht operimi në çdo fshat bëhet nga UK Sarandë. Në muajin Prill 2013, Audituesi i pavarur i ngarkuar nga KFW auditoi performancën e UK-ve ku rezultoi që vetëm UK Lezhë dhe UK Gjirokastrë kishin plotësuar kushtin e dytë të vendosur që lidhej direkt me mbulimin e kostove të operimit. Për UK Fier dhe UK Sarandë u krye auditimi i dytë në muajin Tetor 2013 ku përfundimisht rezultoi që të dy shoqëritë plotësuan kriteret e vendosura. Këto shërbime përfunduan në datë 23 Shtator 2014. Në datën 18 Shtator 2014 u organizua workshop final me përfaqësues të KFW, SECO, EU, DPUK, ERRU dhe ndërmarrjeve ku u diskutua progresi gjatë periudhës tre-vjecare të komponentit të mbështetjes institucionale. Gjithashtu u përgatit nga konsulentit raporti përfundimtar për kontratën e komponentit institucional.

Komponenti i Zbatimit:

Nga konsulentit u përfundua hartimi i projekteve të detajuara teknike për të katër qytetet të cilat janë miratuar nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve, DPUK dhe KFW. Gjithashtu u përgatitën dokumentat e tenderit dhe gjatë periudhës Prill – Shtator 2014 janë publikuar dhe dorezuar ofertat

nga kompanite e interesuara. Vlerësimi i ofertave për të katër qytetet duke përfshirë të tre fazat (ligjore-administrative, teknike, financiare) u krye dhe pritët të përfundojë në periudhën Gusht 2014 – Janar 2015. Faza e negociemeve të kontratave mendohet të kryhet gjatë muajit Janar – fillim Shkurt 2015 dhe kontratat e punimeve pritët të firmosen brendamuajit Shkurt 2014. Fillimi i punimeve në terren që ndodh pas fazës së mobilizimit të kontraktorëve, pritët të jetë në periudhën Shkurt - Mars 2015.

Lezhe: Kontrata e punimeve është firmosur në datën 11.12.2014 dhe gjithashtu nga Bashkia Lezhe është pranuar aplikimi për miratimin e lejes së ndërtimit dhe është në proces zbardhje leja në emer të kontraktorit. Aktualisht po procedohet pagesa e paradhenies dhe në fillim të muajit Shkurt 2015 mendohet të fillojnë punimet në terren. Afati i kryerjes së punimeve është 24 muaj kalendarike.

Gjirokastrë: Tenderimi është përfunduar në datë 22.10.2014.

Nuk është proceduar me negociemet e kontrates pasi komponenti i Gjirokastrës ka një bashkefinancim prej 2 milion euro nga Bashkimi Europian me afat skadimi të fondeve në 31.12.2015. Për këtë buxhet nga BE mandati i menaxhimit i është dhe në KFW. Për arsye se koha e zbatimit të punimeve është 18 – muaj kalendarike dhe shkon përtej afatit të skadimit të fondeve nga KFW që prej një periudhe gati 6- muajore është dërguar kërkesa tek BE dhe janë kryer bisedime deri në nivelin më të lartë të menaxhimit të këtyre institucioneve për shtyrjen e afatit të fondeve. Nga BE është premtuar si afat përfundimtar për përgjigjen data 31.01.2015. Nga KFW është premtuar që brenda datës 31.01.2015 do të jepet përgjigje pozitive për të proceduar me firmosjen e kontrates së punimeve dhe fillimin e punimeve në terren.

Afati i kryerjes së punimeve është 18 muaj kalendarike.

Sarandë: Tenderimi është përfunduar në datë 20.01.2015. Negociemet e kontrates mendohet të kryhen deri në datë 29.01.2015 për të proceduar më tej me firmosjen e kontrates dhe fillimin e punimeve në terren.

Fier: Nuk ka përfunduar tenderimi dhe pritët të finalizohet brenda muajit Janar 2015.

Nuk është proceduar me aprovimin vlerësimit financiar pasi komponenti i Fier ka një bashkefinancim prej 2 milion euro nga Bashkimi Europian me afat skadimi të fondeve në 31.12.2015. Për këtë buxhet nga BE mandati i menaxhimit i është dhe në KFW. Për arsye se koha e zbatimit të punimeve është 24 – muaj kalendarike dhe shkon përtej afatit të skadimit të fondeve nga KFW që prej një periudhe gati 6- muajore është dërguar kërkesa tek BE dhe janë kryer bisedime deri në nivelin më të lartë të menaxhimit të këtyre institucioneve për shtyrjen e afatit të fondeve. Nga BE është premtuar si afat përfundimtar për përgjigjen data 31.01.2015. Në varesë të vendimit të BE nga KFW do të vendoset si do procedohet me financimin e punimeve, duke përfshirë apo jo financimin e BE.

Aafati i kryerjes së punimeve është 24 muaj kalendarike.

2. Programi i Infrastrukturës Komunale II – Qytetet Kamëz, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Fier, Sarandë

Vlera: 34,482,000 Euro; 14,000,000 Euro (Kredi) e bute nga KFW dhe 20,482,000 Euro (Grant) nga Bashkimi Europian (BE)

Afati: 2012-2016

Donatori: KFW, Komiteti Europian (KE)

Objektivat:

Rehabilitimi i sistemeve të ujësjellës kanalizimeve për qytetet: Fier, Sarandë, Berat, Kuçovë, Lushnjë dhe Kamëz me qëllim përmirsimin e situatës së furnizimit me ujë dhe sanitetit, si dhe rritjen e performancës së ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve që operojnë këto sisteme. Në kuadër të këtij programi janë përfshirë dhe qytetet e Fierit dhe Sarandës që ishin pjesë e Programit I, për shkak të nevojave për investime.

Roli i DPUK-së është "Përgjegjës Programi" dhe roli i Ndërmarrjeve të Ujësjellës Kanalizimeve është "Përgjegjës Projekti". Në kuadër të Programit nga DPUK u kontraktuan "Konsulentit Institucional" dhe "Konsulentit i Zbatimit", ku secili është përgjegjës për aktivitetet në të gjitha ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve që janë pjesë e programit. Nga ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve kontraktohen "Kontraktorët e Punimeve". Në fund të muajit Dhjetor 2011 janë

negociuar marrëveshjet e kredisë dhe grantit të miratuara në Qeverinë Gjermane dhe Qeverinë Shqiptare si dhe janë ratifikuar në Parlament.

Komponenti Institucional:

Eshtë negociuar me konsulentin institucional të fazës së parë të programit Haskoning, ofrimi i shërbimeve për qytetet Lushnjë, Kamëz dhe kanë filluar shërbimet. Gjithashtu në kuadër të kësaj shtojce janë detajuar shërbimet për qytetin e Sarandës që ishin ofruar gjatë dorëzimit të ofertës së fazës së parë. Shërbimet në qytetin e Kamzës kanë qënë të limituara deri në hartimin e planit të biznesit dhe strategjisë së tarifave pasi shërbimet afatgjata u përfshinë në kontratën e konsulentit të zbatimit. Ka përfunduar hartimi i planit të biznesit dhe strategjisë së tarifave dhe u aprovuan nga këshilli mbikqyrës dhe dorëzuar tek ERRU. Në muajin Shkurt 2014 u krye auditimi i pavarur nga KFW për UK Berat-Kuçovë, UK Lushnjë dhe UK Kamëz dhe rezultoi që të gjitha shoqëritë plotësuan kriteret e performancës të vendosur në kuadër të programit duke i hapur rrugë procesit të tenderimit të punimeve. Shërbimet për qytetet Sarandë dhe Lushnjë përfunduan në datë 23 Shtator 2014. Në datën 18 Shtator 2014 u organizua workshop final me përfaqësues të KFW, SECO, EU, DPUK, ERRU dhe ndërmarjeve ku u diskutua progresi gjatë periudhës tre-vjecare të komponentit të mbështetjes institucionale. Për qytetin Kamëz mbështetja institucionale është e përfshirë brenda kontratës së konsulentit teknik të zbatimit. Deri tani është krijuar database i ri elektronik i të dhënave të klientëve, është instaluar programi kompjuterik i faturim - arkëtimeve dhe është printuar fatura elektronike si dhe vazhdon mbështetja për stafin e ndërmarrjes.

Komponenti i zbatimit:

Berat-Kuçovë, Lushnjë

Nga konsulenti ka përfunduar hartimi i projekteve të detajuara teknike për të tre qytetet të cilat janë miratuar nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve, DPUK dhe KFW. Gjithashtu janë përgatitur dokumentat e tenderit dhe gjatë periudhës Qershor – Korrik 2014 janë publikuar prokurimet e punimeve. Dorëzimi i ofertave u parashikua në periudhën Gusht - Shtator 2014. Vlerësimi i ofertave duke përfshirë të tre fazat (ligjore-administrative, teknike, financiare) pritet të përfundojë brenda muajit Janar 2015. Faza e negociimeve të kontratave mendohet të kryhet gjatë muajit Janar – fillim Shkurt 2015 dhe kontratat e punimeve pritet të firmosen brenda muajit Shkurt 2015. Fillimi i punimeve në terren që ndodh pas fazës së mobilizimit të kontraktorëve, pritet të jetë në Shkurt të 2015.

Kamëz

Për komponentin e Kamzës në bashkëpunim me KFW-në, Bashkimin Evropian, Bashkinë Kamëz u vendos varianti teknik dhe përcaktuan investimet që do të kryhen në kuadër të fondeve të miratuara. Nga konsulenti ka përfunduar hartimi i projektit të detajuar teknik për të cilin nga DPUK dhe KFW janë adresuar komente. Është dërguar nga konsulenti versioni përfundimtar i rishikuar dhe në datë 21.10.2014 nga KFW janë dërguar komentet e fundit të cilat janë finalizuar dhe aprovuar nga KFW. Në datën 22.12.2014 u aprovuan nga KFW dokumentat e tenderit duke hapur rrugë publikimit të prokurimit të punimeve. Dorëzimi i ofertave është në muajin Shkurt dhe procesi i tenderimit së bashke me kontraktimin e punimeve mendohet të përfundojë brenda gjashtë muajit të parë të vitit 2015.

Lushnje: Tenderimi është përfunduar në datë 13.01.2015. Në datë 20.01.2015 janë zhvilluar negociimet e kontratës dhe aktualisht po finalizohet kontrata. Mendohet që punimet në terren të fillojnë në muajin Shkurt 2015.

Berat-Kuçovë: Tenderimi është përfunduar në datë 17.01.2015. Në datë 23.01.2015 do të zhvillohen negociimet e kontratës dhe aktualisht po finalizohet kontrata. Mendohet që punimet në terren të fillojnë në muajin Shkurt 2015.

KAMËZ: Publikimi i prokurimit është bërë në datë 03.01.2015 dhe dorëzimi i ofertave është në 20 Shkurt 2015. Procesi i tenderimit së bashke me kontraktimin e punimeve mendohet të përfundojë brenda gjashtë muajit të parë të vitit 2015.

3. Programi i Infrastrukturës Bashkiake III & IV me një vlerë 35 milion euro kredi e butë nga KfW, 4.14 milion euro grant nga KFW dhe 11 milion euro Grand nga SECO (Qeveria e Zvicres).

Objektivi i përgjithshëm i Programit është sigurimi i shërbimit të qëndrueshëm dhe financiarisht të përballueshëm të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të

përdorura për qytetarët të cilët jetojnë në qytetet e Beratit, Kuçovës, Gjirokastrës, Kamzës, Lushnjës, Delvinës, Librazhdit, si dhe përmirësimi i treguesve të performancës për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të këtyre bashkive.

Programi në vetvete do të implementohet në dy faza:

Faza1: Konsiston në planifikimin dhe specifikimin e investimeve nëpërmjet përditësimit dhe hartimit të studimeve të realizueshmërisë nga konsulenti teknik. Gjithashtu shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të mbështeten nga konsulenti institucional me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës për të arritur kriteret e programit të vendosura si kusht paraprak për të proçeduar me hapat e zbatimit të projektit.

Faza 2: Konsiston në zbatimin e investimeve të planifikuara nëpërmjet analizës së detajuar të studimeve të realizueshmërisë të përgatitura nga konsulenti teknik. Shërbimet kryesore që do të kryhen gjatë kësaj faze nga konsulenti teknik konsistojnë në hartimin e projekteve të detajuara teknike, përgatitjen e dokumentave të tenderimit të punimeve si dhe mbikqyrjen në terren të punimeve gjatë zbatimit të projekteve. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të marrin mbështetje institucionale të mëtejshme për të patur operim të qëndrueshëm të investimeve, për të përmirësuar efikasitetin dhe lehtësuar zbatimin e planit të biznesit, planeve të operim mirëmbajtjes si dhe planit të ndryshimit të tarifave.

Shuma e financimit grant dhe kredi të akorduar nga Kontributi Zviceran dhe Gjerman është rreth 50 milionë euro.

Gjate vitit 2014 është negociuar marrëveshja e financimit grand nga Kontributi Zviceran në vlerën e rreth 11.6 milion euro dhe nga Kontributi Gjerman në vlerën e 2.14 milion euro. Në vitin 2015 është programuar negociimi i marrëveshjeve të huasë nga KFW.

Pas miratimit të marrëveshjeve të financimit grant janë hapur procedurat e prokurimit të shërbimeve të konsulentit institucional dhe konsulenteve teknike. Të gjitha fazat e vlerësimit si dhe fillimi i shërbimeve mendohet të perfundojnë brenda gjashtë muajve të vitit 2015.

4. Master-Plani kombëtar i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit dhe trajtimit të ujrave të përdorura

Projekti u zhvillua në periudhën Mars 2011 – Korrik 2012 dhe pas dorëzimit të raportit draft dhe marrjes së komenteve nga të gjithë aktorët u finalizua Raporti Përfundimtar i Studimit të Master Planit dhe rezultatet përfundimtare u prezantuan në workshop final të zhvilluar në datat 29 – 30 Prill 2013 me prezencën e të gjithë aktorëve të sektorit duke përfshirë dhe komunitetin e donatorëve ndërkombëtarë të sektorit. Procedura në vijim konsiston në miratimin e studimit nga Këshilli i Ministrave.

5. Mbrojtja mjedisore e liqenit të Ohrit, Kanalizimet e Ujërave të Zeza Pogradec (Faza III)

Vlera: 13,456,250 Euro 10,000,000 Euro (Kredi) KFW dhe 3,456,250 Euro (Grand) CEB

Afati: 2011-2016

Donatori: CEB dhe KFW

Kjo fazë konsiston në marrjen e një kredie prej 10 milion euro nga KFW dhe 3.5 milion euro Grant nga fondet e EU, Programi IPA. Nga KFW në muajin Shtator 2009 u caktua një ekspert për të vlerësuar situatën dhe përcaktuar nevojat për investime. Punimet do të konsistojnë kryesisht në përfundimin e ndërtimit të rrjetit grumbullues të ujërave të zeza në të gjithë zonën e qytetit Pogradec, ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve në zonën përgjatë lumit të fshatit Vërdovë që shkarkon në liqen duke përfshirë dhe sistemin e fshatit Vërdovë, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Rrëmenj, ndërtimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në fshatin Gurreas dhe ndërtimin e veprës së marrjes së ujit të pijshëm, stacionit të pompimit dhe linjës kryesore të transmetimit për sistemin e ujësjellësit të fshatrave Gurras, Bahçallëk dhe Gështenjës. Në fillim të vitit 2011 u ratifikua marrëveshja e kredisë, grantit dhe nga "UK Pogradec" u kryen procedurat e tenderimit për përzgjedhjen e konsulentit që do të kryejë hartimin e projektit të zbatimit dhe supervizionin e punimeve. Kontrata me konsulentin u lidh në muajin Shtator 2011. Në vitin 2012 u publikua prokurimi i punimeve dhe dorëzimi i ofertave është bërë në muajin Dhjetor 2012. Punimet filluan në 29.04.2013. Realizimi fizik i punimeve për kontratën fillestare ka arritur në nivelin 81%. Afati i përfundimit të punimeve është 20.03.2015. Gjate vitit 2014 me fondet e siguruara gjate procesit të tenderimit të punimeve u ra dakord për financimin e komponenteve të tjera të sistemeve të ujësjellës

– kanalizimeve te paperfshire ne fazat e tjera dhe ne date 22.11.2014 me kontraktorin ekzistues u firmos kontrata shtese e punimeve. Afati i perfundimit te punimeve eshte 30.11.2015.

Në muajin Maj 2014 u lidh kontrata për furnizimin e paisjeve të parashikuara në kuadër të projektit dhe është bërë furnizimi në muajit Gusht 2014. Furnizuesi ka perfunduar fazën e trajnimeve dhe paisjet jane marre ne dorezim përfundimtar.

6. Projekti i Kanalizimeve Korça III dhe IV, IPA 2010

Vlera: 4,018,000 Euro (Grand)

Afati: 2012-2015

Donatori: Komiteti European (KE)

Ky projekt konsiston në ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve, për pjesën e mbetur pa ndërtuar gjatë fazave të mëparshme. Në vitin 2012 është kontraktuar konsulenti për të kryer rishikimin e projektit të detajuar teknik, përgatitjen e dokumentave të tenderit dhe supervizionimin e punimeve. Pas rishikimit të projektit është hapur procedura e tenderimit dhe në datë 14 Gusht 2013 janë dorëzuar dhe janë hapur dokumentat e tenderit të zbatimit të katër firmave konkurrese. Në Janar të 2014 është firmosur kontrata me kontraktin e suksesshëm. Te gjitha punimet e parashikuara ne kontraten baze kanë realizim fizik në masën 100%. Jane aprovuar gjithashtu dy shtesa kontratash ku realizimi fizik i punimeve eshte rreth 60%. Te gjitha punimet mendohet te perfundojne brenda vitit 2015.

7. Furnizimi me ujë i Qytetit Bilisht

Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë “Turn key Silver Book”

Kontraktor Duktus Austri

Fillimi i shërbimeve: 23.01.2012

Data e përfundimit të Kontratës: 23.10.2013

Nga Ministria e Transportit Austri u krye procesi i tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorit që do të kryejë punimet dhe u firmos kontrata. Në fillim të muajit Janar 2012 u njoftuam nga Ministria e Financave zyrtarisht për përmbylljen e marrëveshjes financiare me Bankën “UniCredit” dhe hyrjen në fuqi të kontratës. Kontrata filloi ne muajin Shkurt 2012 dhe perfundoi ne muajin Tetor 2013. Kane perfunduar te gjitha punimet dhe ne periudhen 11 - 15 nentor 2013 u krye procedura e dorezimit te punimeve dhe venies ne pune te sistemit. Punimet kaluan ne faze garanci difektesh prej 12 muajsh qe perfundoi ne 15.12.2014. Gjate fazes se garancise jane kryer 4 inspektime te planifikuara dhe jane lene detyra te cilat jane plotesuar nga kontraktori. Qe prej venies ne funksion te sistemit te ri ndryshimi eshte i prekshem ne raport me orarin e furnizimit 24 ore, cilesine e sherbimit dhe treguesit e performances se shoqerise se ujesjellesit.

8. Kanalizimet e qytetit Bilisht

Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë “Turn key Silver Book”

Kontraktor Strabag AG Austri

Firmosja e Kontratës: 30.06.2014

Procedurat e tenderit për përzgjedhjen e kompanisë që do të zbatojë Projektin janë kryer në Austri sipas ligjit austriak dhe fituese është shpallur firma STRABAG AG me të cilën Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës – DPUK ka lidhur një kontratë blerjeje më 30 Qershor 2014. Faza I e cila do të financohet nëpërmjet kësaj kredie të butë në vlerën 2,998,856 EUR, përfshin:

- Rrjetin e ri kryesor të sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza për zonën qendrore të qytetit, me një gjatësi totale të tubacioneve rreth 17.4 km, me tubacione PVC-u DN200 dhe DN250;
- Kolektorin e ri kryesor të sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza të qytetit, me një gjatësi totale rreth 1.7 km, me tubacion PVC-u DN400;
- Instalimin e pusëve kryesore të sistemit të shkarkimit të ujërave të zeza, rreth 370 copë të tipit PP DN1000;
- Lidhjen me rrjetin e ri të shkarkimit të ujërave të zeza të rreth 1500 lidhjeve;

- Rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara për pjesën e kanaleve që do të hapen do të bëhet me asfalt;
- Rehabilitimi i rrugëve të shtruara me asfalt. Për këtë fazë janë parashikuar dhe rreth 25,000 m2 rrugë të riasfaltuara në të gjithë gjerësinë e tyre;
- Shërbime konsulence për hartimin e projektit të detajuar teknik, trajnime dhe mbikëqyrje të realizimit të punimeve.

Projekt – Vendimi për Marrëveshjen e huasë u miratua në Këshillin e Ministrave gjatë muajit Shtator 2014 dhe u dërgua në parlament për tu shqyrtuar në komisione dhe seance. Në datën 16.10.2014 u bë shqyrtimi në komisionin parlamentar të ligjeve dhe veprimtarive prodhuese. Shqyrtimi në komisionin parlamentar u bë në datë 30.10.2014, ku në të njëjtën datë u bë dhe miratimi në seancë plenare. Pas miratimit në parlament marrëveshja e miratuar u botua në fletoren zyrtare dhe pritët konfirmimi nga pala austriake tek Ministria e Financave për plotësimin e kushteve paraprake për hyrjen në fuqi të marrëveshjes dhe më pas njoftimi tek DPUK për hyrjen në fuqi të marrëveshjes. Pas marrjes së njoftimit DPUK në rolin e punëdhënësit do të njoftojë kontraktorin për hyrjen në fuqi të kontratës dhe fillimin e projektit.

9. Furnizimi me ujë i Qytetit Peshkopi

Kontratë ndërtimi me çelsa në dorë “Turn key Silver Book”

Kontraktor Duktus dhe konsulent Ostap Engineering

Firmosja e Kontratës: 24.07.2013

Në kuadër të buxhetit të projektit prej 4 milion Euro do të realizohen:

- Zëvendësim i rreth 33,000 ml rrjet shpërndarës ujësjellësi
- Instalim i rreth 50 hidrantëve të ujit
- Ndërtim i një stacioni pompimi shtytës për të furnizuar zonën në kuotë të lartë në jug-lindje të qytetit
- Instalim i tre reduktuesve të presionit për zonën në kuotë të ulët të qytetit
- Instalim i lidhjeve të konsumatoreve duke përfshirë dhe instalimin e rreth 3,500 matësave
- Rehabilitim i rezervuarëve ekzistues nr.1, 2, 3
- Shërbime konsulencë për hartimin e projektit të detajuar teknik, trajnime dhe mbikëqyrje të realizimit të punimeve

Projekti financohet në kuadër të bashkëpunimit financiar me Qeverinë Austriake.

Marrëveshja e huasë u miratua në parlament gjatë muajit Korrik 2014. Në datën 15

Tetor 2014 është dërguar nga Ministria e Financave tek MTI njoftimi për bërjen efektive

të marrëveshjes së kredisë për financimin e projektit. DPUK ka marrë në rrugë elektronike nga MTI njoftimin në datë 20.10.2014 dhe në datë 21.10.2014 ka njoftuar kontraktorin për hyrjen në fuqi të kontratës së kryerjes së punimeve. Në datën 22.10.2014 Kontraktori ka njoftuar fillimin e punimeve në datën 27.10.2014. Kohezgjatja e punimeve është 18 muaj kalendarike. Aktualisht ka përfunduar testimi i rrjetit ekzistues të ndërtuar nga investimi nepermjet Bankes Islamike per Zhvillim me qellim venien ne eficence te plote dhe integrimin me sistemin e ri te plote qe do te kryhet nga ky investim. Paralelisht po hartohet projekti i detajuar teknik qe pritët te dorezohet brenda dates 23 Janar 2015. Pas miratimit të projektit i hapet rruga fillimit të punimeve në terren.

PROJEKTI I RI NE FUSHEN E UJIT BB

I. Informacion për komponentet e projektit të Durrësit.

Referuar Studimeve të mëparshme të realizuar nga DPUK, në lidhje me përmirësimin e shërbimit me ujë në Qytetin e Durrësit rezultoi se përveç përmirësimit të menaxhimit të ndërmarrjes faktor kryesor që ndikon në kohëzgjatjen e furnizimit është dhe mungesa e sasisë së ujit. Referuar

studimeve te Rodecos, IC Konsulente, COWI te financuar nga Banka Botërore rezulton se aktualisht mungesa e sasisë se ujit ne qytetin e Durrësit është 300l/s.

Ne këto kushte qeveria Shqiptare i kërkon Bankës Botërore përgatitjen e një projekti te ri ne fushën e ujit me fokus qytetin e Durrësit.

Faza përgatitore e projektit filloi ne vitin 2010 dhe u financua nga një Grant i Bankës Botërore me vlere 950,000 USD.

Gjate fazës përgatitore u financua një studim fisibiliteti ku u vërtetua se mungesa e sasisë se ujit për qytetin e Durrësit ne vitin 2010 është 300l/s dhe arrin ne 600l/s ne vitin 2040. Pra, si konkluzion doli se për përmirësimin e shërbimit te furnizimit me ujë ne zonën e shërbimit te NUK Durrës është e domosdoshme përveç përmirësimit te menaxhimit, shtimi i sasisë se ujit.

Referuar një studimi te kryer ne vitet 2008-2009 nga IC konsulente ne lidhje me alternativat e burimeve te ujit qe mund te furnizonin NUK Durrës, baseni i Fushëkuqes dhe i lumit te Matit, rezulton te jete alternativa afatmesme me e mire e mundshme.

Pas konsultimeve te MPPT, Qeverise, Bankës Botërore, DPUK_ja nëpërmjet njësisë se implementimit te projekteve te BB, filloi përgatitjen e projektit te detajuar për një linje te re furnizimi nga Baseni i lumit Mat te dedikuar për qytetin e Durrësit. Linja e re parashikohet te sjelle ne qytet 630 l/s.

Përveç projektit te detajuar te linjës se re, puseve, dhe stacionit te pompimit, nëpërmjet Grantit te mësipërm u financua dhe studimi mjedisor dhe social i projektit.

Pas përfundimit te projektit te detajuar te linjës, njësia e implementimit dhe Banka Botërore filluan përgatitjen e Dokumentit te Vlerësimit te Projektit, (Project Appraisal Document, PAD).

PAD përfundoi ne Prill 2012 dhe menjëherë filluan negociatat me Ministrinë e Financave për marrëveshjen Financiare. Pavarësisht se ne parim Marrëveshja Financiare u aprovua nga përfaqësuesit e Ministrisë se Financave, Minutat Përfundimtare te Negocimit nuk u firmosen. Për pasoje, Projekti nuk u paraqit për aprovim as ne Bordin e Bankës Botërore.

Projekti konsiston ne komponentët e mëposhtëm

- *Komponenti i Investimeve Prioritare*, ne te cilin futet financimi i linjës se re te Furnizimit përfshire një stacion, te ri pompinji ne Fushëkuqe. Linja do te jete e dedikuar vetëm për qytetin e Durrësit, ndërsa linja ekzistuese pre Çeliku DN 700mm do te përdoret edhe për fshatrat përgjatë linjës. Aktualisht Stacioni i Fushëkuqe prodhon 750l/s dhe maksimumi qe arrin ne Durrës është 500l/s. Linja e re do te përmirësoje shume shërbimin e furnizimit të qytetit dhe zonës se plazhit. Gjithashtu synohet përmirësimi i furnizimit me ujë të gjithë zonës rurale nëpërmjet ndërtimit të linjave të reja të transmetimit dhe rezervuarëve për çdo fshat.
- *Komponenti i Kanalizimeve* nëpërmjet te cilit synohet te përmirësohet dhe zgjidhet problemi i kanalizimit te urave te zeza te zonës se Durrësit, përfshire dhe Plazhin. Qëllimi kryesor është ndarja e sistemeve te ujërave te bardha nga kanalizimet dhe rehabilitimi i linjave kryesore te transmetimit përfshire stacionet e pompimit. Gjithashtu do të mbulohen me rrjet kanalizimesh dhe zonat periferike informate si dhe zona rurale.
- *Komponenti Institucional* nëpërmjet te cilit do te mbështeten politikat e dhe reformat Qeverise ne sektorin e Ujit. Këto Reforma do te përfshijnë një përgatitjen dhe zbatimin e një Programi Monitorim te Kërkesës për Ujë. Ky program synon zbatimin e një programi matjeje për qytetin e Durrësit duke përfshire si klientët familjare ashtu dhe matjen ne pikat e lidhjes ne linjën kryesore.

Zbatimin e një fushate ndërgjegjësimi për mos shpërdorimin e ujit, Mbështetjen e Njesisë se Monitorimit pranë DPUK, Asistence teknike për mbështetjen dhe zbatimin e një modeli efektiv për furnizimin dhe shpërndarjen e ujit etj.

- Komponenti për mbështetjen e Njesisë se Implementimit, nëpërmjet te cilit do te paguhet stafi si dhe shpenzime te tjera operative.

II. Informacion ne lidhje me statusin aktual te projektit

Qëllimi kryesor i projektit është shtimi i sasisë së ujit në qytetin e Durrësit, për këtë arsye e gjithë vëmendja e njësive, e DPUK dhe e Bankës është përqendruar në investimin kryesor, atë të linjës së furnizimit.

Pas përfundimit të dokumenteve të parakualifikimit, në Prill 2014 filloi procesi i parakualifikimit të kompanive të ndërtimit dhe konsulences për këtë kontratë. Raporti i parakualifikimit është çuar për herë të parë në Bankë në muajin Korrik 2014, është kthyer me komente nga Banka duke kërkuar me shumë informacion në lidhje me kompanitë të caktuara. Në muajin Tetor është ricuar dhe kthehet përsëri nga Banka me komente shtesë. Për arsye të komunikimit me aplikantët, raporti final është dërguar në Bankë për "no objection" në Janar 2015. Jemi në pritje të aprovimit nga Banka të listës së kompanive të propozuara nga Komisioni i Vlerësimit.

1. Aktivitetet Kryesore të Projektit

a. Kontrata për Ndërtimin e Linjës së re të Furnizimit

Kjo Kontratë është në proces prokurimi, Është dërguar raporti final i parakualifikimit të kompanive dhe pritët aprovimi i Bankës.

Është në proces dhe brenda muajit Janar përfundon procesi i finalizimit të dokumenteve të tenderit.

Është aplikuar për lejen mjedisore dhe pritët marrja e lejes nga Agjencia Rajonale Durrës

Është në proces finalizimi i dosjes së shpronësimit

b. Kontrata për supervizionin e Linjës

Gjithashtu kjo kontratë është në proces parakualifikimi, është dërguar raporti i shortlistimit së bashku me dokumentet e tenderit dhe pritët aprovimi i Bankës.

c. Kontrata për ndërtimin e rrjetit sekondar të kanalizimeve në zonën e Plazhit në Durrës

Për këtë kontratë është përfunduar Projekti i zbatimit, PIU është duke koordinuar me Bashkinë e Durrës, një pjesë e projektit do të financohet dhe prokurohet nga Bashkia e Durrës dhe është e nevojshme të koordinohet.

Është në proces përgatitja e dokumenteve të tenderit si dhe aplikimi për leje zhvillimore.

d. Kontrata për Projektimin dhe Supervizionin e disa ndërhyrjeve në rrjetin kryesor të kanalizimeve në qytet.

Për këtë Kontratë janë përfunduar termet e referencës dhe janë çuar në Bankë për aprovim. Pas aprovimit do të përgatiten Dokumentet e Tenderit dhe do të shpallet procedura e prokurimit. Shpallja do të bëhet brenda muajit Shkurt 2015.

e. Rishikimi dhe finalizimi i rregullve teknike.

Në lidhje me këtë proces, MTI ka përgatitur qëllimin e punës dhe PIU është duke finalizuar termet e referencës dhe në diskutim me Bankën në lidhje me mënyrën e prokurimit.

f. Plotesimi i Stafit të PIU_t

Raportet e vlerësimit për prokuruesin dhe inxhinierin e Projektit janë çuar në Bankë për aprovim.

Projekti "Furnizimi me Ujë dhe Shërbimet Sanitare

në Orikum".

Projekti "Furnizimi me Ujë dhe Shërbimet Sanitare në Orikum" i financuar nga Banka Islamike për Zhvillim, sipas Marrëveshjes së Kredisë të ratifikuar me ligjin Nr. 10055, datë 22.01.2009 dhe është bërë efektive në datë 12.05.2009.

Vlera e financimit është 16.441.000 USD nga të cilat **13.351.000** USD janë kontribut i **IsDB** (Banka Islamike për Zhvillim) dhe **3.090.000** USD janë kontribut i **GOA** (Qeverisë Shqiptare).

Përfitues të projektit janë Bashkia e Orikum dhe Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve të Orikum.

Data e miratimit:

06/01/2008

Data e firmosjes:	15/11/2008
Data e bërjes efektive (ratifikimi):	12/05/2009
Data e përfundimit:	31/12/2012
Data e shtyrjes së përfundimit të punimeve civile	31/12/2015

• **Qëllimi i projektit**

Projekti "Furnizimi me Ujë dhe Shërbimet Sanitare në Orikum" është një projekt i bashkë financuar nga Qeveria Shqiptare dhe Banka Islamike për Zhvillim, dhe menaxhohet nga (PMU) Njësia e Menaxhimit të Projektit. Marrëveshja e Kredisë është ratifikuar me ligjin Nr. 10055, datë 22.01.2009 dhe është bërë efektive në datë 12.05.2009. Vlera e financimit është 16.441 Milion USD nga të cilat 13.351 Milion USD janë kontribut i IDB (Banka Islamike për Zhvillim) dhe 3.09 Milion USD janë kontribut i Qeverisë Shqiptare. Përfutjes të projektit janë Bashkia Orikum dhe Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve shp Orikum.

• **Objektivat e Projektit**

1. Projekti synon përmirësimin e furnizimit me ujë për fshatrat Radhimë, Tragjas, Dukat i ri, Dukat i vjetër, qytetin e Orikumit si dhe gjithë vijës bregdetare Radhimë-Orikum.
2. Ndërtimin e rrjetit kryesor të kanalizimeve për qytetin e Orikumit, fshatrat Radhimë, Dukat i Ri, dhe vijës bregdetare Radhimë-Orikum.
3. Ndërtimin e një Impianti Trajtimi të Ujërave të Zeza me kapacitet trajtimi 4000 m³ në ditë, i cili do trajtojë gjithë ujërat e zeza të zonës së projektit.

• **Çfarë zgjidh aktualisht projekti**

Me përfundimin e projektit të miratuar, i cili po zbatohet aktualisht, merr zgjidhje problemi i furnizimit me ujë 24 ore si dhe arrihet përmirësimi i shërbimeve sanitare në qytetin e Orikumit, fshatrat Radhimë, Tragjas, Dukat i Ri, si dhe zonës bregdetare Radhimë – Orikum.

Më konkretisht me përfundimin e kësaj faze të projektit arrihen këto objektiva sipas marrëveshjes së kredisë:

Shtirja e linjave kryesore për furnizimin me ujë, **(11600 ml janë linja furnizimi, 21150 ml janë linja shpërndarjeje)** ndërtimin e 5 depove të ujit, veprat e marrjes në burimet e caktuara, dhe stacionet e pompave të ujësjetës të llogaritura për numrin aktual të banorëve dhe një kapaciteti pushuesish gjatë sezonit turistik prej 30 000 pushuesish në sezon.

Zona	Numri i Popullsisë	Ore furnizimi me ujë aktuale	Ore Furnizimi në Përfundim të projektit	Sasia e furnizimit me ujë në Përfundim të Projektit
Orikum	6785	6	24	150 litra/banorë/dite
Radhim	1491	5	24	150 litra/banorë/dite
Tragjas	1961	5	24	150 litra/banorë/dite
Dukat i Ri	5137	6	24	150 litra/banorë/dite
Zone Bregdetare	30000/vit	0	24	150 litra/banorë/dite

Porsa i përket rrjetit të kanalizimeve projekti aktual përmirëson ndjeshëm sistemin sanitar në zonë duke ndërtuar rrjetin kryesor të kanalizimeve për fshatin Radhimë, Dukat i Ri, qytetin e Orikumit si dhe gjithë vijës bregdetare Radhimë-Orikum. Pjesë e projektit janë shtrimi **22705 ml** tubacion HDPE me diametër që variojnë nga 250-700 mm, si dhe ndërtimin e 4 stacionesh pompimi për ujërat e zeza.

	Numri Popullsisë	i Rrjet Kanalizimesh Aktual	Rrjet i Ri Kanalizimesh
Orikum	6785	Po	Po
Dukat I Ri	5137	Jo	Po
Radhim	1491	Jo	Po
Zone Bregdetare	30000/vit	Jo	Po

Gjithashtu pjese e projektit aktual është dhe ndërtimi i një Impianti të Trajtimi të Ujërave të Zeza që do mbliidhen nga linjat e kanalizimeve të përmendura më lart, me kapacitet trajtimi 4000m³/dite

• **Objektivat per vitin 2015**

Synojme perfundimin e projektit pra realizimin e qellimit te marrveshjes qe eshte infrastruktura kryesore për furnizimin me ujë si dhe rritja sasia e depozituar, si dhe mënyra e shpërndarjes nëpërmjet ndërtimit te depove te reja si dhe stacioneve te reja te pompimit. Konkretisht:

Perfundimin e plote te pjeses se mbetur te sistemit te shperndarjes ose 1,057 ml, perfundimin dhe venien ne pune te depos se ujit ne Orikum me kapacitet 2000 m³, perfundimin e investimit per punimet e pampave te ujit dhe sistemit te veprave te marrjes.

Gjithashtu perfundimin e punimeve te mbetura per rrjetin e KUZ si dhe perfundimin e Impiantit te Trajtimit te Ujërave te zeza.

Zgjatimin e linjës kryesore të K.U.Z të vijës bregdetare në një gjatësi edhe prej 1.5 km nga ajo që është shtrirë gjatë fazës së parë të projektit për të bërë të mundur që një numër i madh hotelesh dhe biznesesh te lokalizuar në këtë segment të kenë mundësi lidhje me rrjetin e kanalizimeve. Perfundimin e ndertimit te sistemit te pompimit te rrjetit.

Projektet me financim të qeverisë Italiane

1.Programi “Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës” (27.475.432 Euro)

Vlera: 10.335.000 euro(kredi)

Afati: 2014-2016

Donatori: Qeveria Italiane

Në vijim të protokolleve të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë Italiane dhe asaj Shqiptare, me datë 15.05.2000, është nënshkruar Memorandumi Teknik i Mirëkuptimit midis palës italiane dhe asaj shqiptare. Rezultati i këtij Memorandumi është materializuar në Marrëveshjen Finaciare ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Artigiancassa, “Për Financimin e Përbërësve të Asistencës teknike për ndërmarrjen e Ujrave dhe Ndërhyrjeve Infrastrukturore të Rrjetit Hidrik, në Kuadër të projektit “Rehabilitimi të Rrjetit Hidrik të Tiranës”, Ligji Nr.8619, datë 14.06.2000, me vleftë 27.475.432 Euro.

Objekti i përgjithshëm i këtij programi është rehabilitimi i rrjetit hidrik në rajonin e Tiranës nëpërmjet ndërhyrjeve Infrastrukturore me qëllim përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë, sanitetit, uljes së humbjeve në rrjet si dhe rritjen e performancës së Ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizimeve Tiranë në rolin e përfuturit përfundimtar të programit dhe përgjegjësit kyesor për operimin e këtij sistemi.

Si rezultat, në përfundim të fazës së parë të programit, fondet e papërdorura në kuadër të kësaj marrëveshje Finaciare rezultojnë sot në vlerën 10.335.000 euro

Gjate vitit 2014 DPUK, i ka kërkuar disa herë zyrtarisht Zyrës së Kooperacionit Italian në Tiranë aktivizimin e buxhetit prej 10.335.000 euro, me qëllim përdorimin e tij për përmirësimin e rrjetit hidrik në rajonin e Tiranës.

Firmosja e Protokollit të Bashkëpunimit për Zhvillim 2014-2016 ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj Italiane në 12.12.2014 solli dhe angazhimin eparë tepalëve për të aktivizuar fondet e sipërmendura duke ju referuar objektivave të programit fillestar firmosur në 15.05.2000.

Në këtë kuadër, DPUK/PIU Shërbime Esenciale në bashkëpunim me Zyrën e Kooperacionit Italian në Tiranë në fillim të vitit 2015 ka filluar punën për realizimin e një analize të detajuar të situatës tërëjtë hidrik në rajonin e Tiranës, me objektivin kryesor realizimin e studimit të fizibilitetit si dhe hartimin e Termave të Referencës për garën e shërbimeve të inxhinierisë (projektim /supervizim)

Gjatë vitit 2015, DPUK ka si objektiv kryesor realizimin e studimit të fizibilitetit brënda muajit prill 2015, të hartojë dokumentacionin e nevojshëm për garën e shërbimeve inxhinierike (projektim-supervizim) si dhe brënda vitit 2015 të realizojë shpalljen e garës për shërbimet në fjalë. Arritja e këtyre objektivave konsiderohet sfidë për afatet e synuar pasi enti financues duhet të japë miratimin e tyre për procedurat e sipërmendura dhe koha që marrin në dispozicion është e konsiderueshme.

2. Programi “Periferitë Urbane të Tiranës- Komponenti Infrastrukturor” 3.000.000 (kredi) Faza e parë

Vlera: 937,517.50 euro (Faza e dytë))

Afati: 2014-2016

Donatori: Qeveria Italiane

Në kuadër të marrëveshjes ndërqeveritare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Italiane, ratifikuar me ligjin nr. 9237 datë 10.06.2004 është realizuar objekti “Punime të Urbanizimit Parësor Laprakë, Tiranë”. Objektiv i përgjithshëm i programit është të garantojë banorëve të zonave periferike të Tiranës përmirësim të cilësisë së jetës dhe një menaxhim më të mirë të shërbimeve urbane, nëpërmjet ndërhyrjeve infrastrukturore.

Faza e parë e këtij projekti ka përfunduar në 12.06.2009 dhe pasi ka kaluar të gjitha procedurat e parashikuara nga detyrimet kontraktuale është kolauduar dhe dorëzuar përfituesit përfundimtar, Bashkisë Tiranë.

Si rezultat fondet e papërdorura në kuadër të kësaj Marrëveshje Financiare (akoma në fuqi), të konfirmuara dhe nga Ministria e Financave janë 937,517.50 euro.

Dpuk ka arritur të marrë zyrtarisht në korrik të 2014 aprovimin për përdorim të këtij fondi nga enti financues referuar prioritetet e përfituesit përfundimtar (minibashkia nr. 11) si dhe analizës së detajuar të situatës aktuale në zonën ku parashikohet ndërhyrja. Në kushtet kur buxheti prej 937,517.50 euro në dispozicion është relativisht i vogël, DPUK është angazhuar dhe në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Kooperacionit Italian në Tiranë deri në dhjetor 2014 ka realizuar projektimin fillestar dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për garën e supervizimit dhe atë të punimeve.

Synohet që brënda muajit shkurt 2015 të realizohet shpallja e garës së punimeve dhe ajo e supervizimit, të përfundohet procesi i vlerësimit të ofertave të garave në fjalë si dhe të merren aprovimet nga enti financues brënda muajit qershor 2015. Sfidë jonë është fillimi i punimeve brënda muajit shtator 2015.

3. Programi “Menaxhimi Mbetjeve të Ngurta të Tiranës” 6.000.000 euro

Kredi +400.000 grant

Projekti “Ndërtimi i impiantit të pastrimit të ujrave të ndotura në vend-depozitimin e mbetjeve të ngurta në Sharrë”. (Faza e dytë).

Vlera: 1.123,127 euro (kredi)

Afati: 2013-2016

Donatori: Qeveria Italiane

Objekti i përgjithshëm i programit është reduktimi i rrezikut mjedisor dhe shëndetësor duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës në rajonin e Tiranës si dhe reduktimi i rrezikut mjedisor dhe shëndetësor duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së popullatës në rajonin e Tiranës nëpërmjet sjelljes në standarte europiane të ujit të ndotur që rrjedh nga vendepozitimi i mbetjeve të ngurta në Sharrë.

Faza e parë e projektit që përfshinte projektin "Rehabilitimin dhe Zgjerimin e Vend Depozitimit të Mbetjeve të Ngurta të qytetit të Tiranës në Sharrë(4.8 milionë euro + 400 mijë euro Grant) ka përfunduar, është kolauduar dhe i është dorëzuar Përfutuesit përfundimtar Bashkisë Tiranë që në dhjetor 2012.

Me qëllim përdorimin e fondit të mbetur për efekt gare prej 1.123.127,38 euro në kuadër të Programit "Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta të Tiranës" i është bërë kërkesë zyrtareKooperacionit Italian në Tiranë për aktivizim të këtij fondi me qëllim realizimin e projektit "Ndërtimi i impiantit të pastrimit të ujrave të ndotura në fushën e Sharrës".

Në bashkëpunim me Zyrën e Kooperacionit Italian në TiranëDPUK ka hartuar dokumentacionin e garës dhe në vitin 2014ka hapur tenderin për shërbimet e inxhinerisëpër realizimin e fazës së dytë "Ndërtimin e Impiantit të pastrimit të Ujrave të Ndotura në sharrë".

Dpuk gjate vitit 2014 ka arritur të përmbyll me sukses garën e shërbimeve të inxhinerisë (projektim supervizim) si dhe ka firmosur kontratën për këto shërbime në tetor të 2014 duke marrë miratimet përkatëse nga enti financues të të gjitha procedurave të kryera në dhjetor të 2014.

Subjekti fitues ka nisur zyrtarisht punën e vet për realizimin e projektit dhe hartimit të dokumentacionit të garës për tenderin e punimeve në janar 2015.

Gjate vitit 2015 synohet realizimi i projektit ekzekutiv dhe hartimi i dokumentacionit per garen e punimeve brënda muajit prill 2015, shpalljen e garës së punimeve dhe vlerësimin e gares ne fjale brënda muajit qershor 2015. Objektivi kryesor është fillimi i punimeve brënda tetorit të vitit 2015. Arritja e këtyre objektivave konsiderohet sfidë për afatet e synuara pasi enti financues duhet të japë miratimin e tyre për procedurat e sipërmendura dhe koha që marrin në dispozicion është e konsiderueshme.

Permisimi i Sistemit te Kanalizimeve dhe Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndoturapër Tiranën e madhe.

Financuesi: Qeveria Japoneze (JICA) Agjensia Nderkombetare per Bashkëpunim e Japonise "JICA" dhe Qeveria Shqiptare

Financimi: Kredi

Vlera Totale: 11,121,000,000.00 Yen (rreth 67 mil Euro)

Afati Kohor Total: 2008-2016

Projekti i Konsulences

Konsulenti: Tokyo Engineering Consult & Europartners Consult

Afati Kohor: 18 Shkurt 2010 deri ne Maj 2015(63Muaj)

Vlera: 1,029,908,916 JPY

Projekti i Ndertimit

Kontraktori: Joint Venture Construzioni Dondi Spa & Kobota Corporation

Afati Kohor: 16 Qershor 2014 – 31 Dhjetor 2016 (30Muaj)

Vlera: 8,168,997,959 JPY

Çështjet aktuale të zhvillimit të projektit sipas kontrates janë si më poshtë:

- Ka perfunduar faza e mobilizimit, ku perfshihet: rrethimi i kantierit, ndertimi i rrjetit te furnizimit me energji elektrike, rrjeti i furnizimit me uje, rruget e brendeshme lidhese, ndertimi i zyrave dhe

magazinave te kantierit, fabrika e betonit etj. dhe jemi ne fazen e zbatimit te projektit sipas listes se meposhteme:

- Ka perfunduar Raporti "Initial Site Survey" i cili perfshin: rilevimin e territorit, sondazhet per infrastrukturen nentokesore ekzistuese, dokumentimin nepermjet fotografimit te situates aktuale etj.
- Eshte bere e mundur pagesa e te gjitha siguracioneve, te cilat ka krijuar mundesine qe te filloje puna pa risqe ne mbulimin e demeve si ne kantierin e STP ashtu dhe ne kantierin e zones A (rrjeti terciar).
- Ka filluar ndertim i rruges devijuse te zones, (rruga komunikuese komunale)
- Ka filluar ndertimi i zyrave te administrates se impiantit te trajtimit te ujrave te ndotura
- Eshte ne fazen e miratimit raporti i "metodes se ndertimit" per murin rrethues mbajtes te sheshit te impiantit.
- Ka filluar ndertimi i rrjetit te kanalizimeve ne zonen A (prane ish kombinatit textil)
- Eshte pezulluar ndertimi i rrjetit te kanalizimeve ne zonen B (prane ures se shkozës sepse ka pasur nje mbivendosje projektesh me ARSH, projekti i reabilitimit te shtratit te lanes)

Nga nje veshtrim i pergjithshem verohet se ecuria e punimeve eshte jo me ritem te plote, mendoj se me nje bashkepunim me te ngushte per "Programin Punes" te ri, te ndertuar me prioritete duke mare parasysh edhe sugjerimet tona dhe te mbeshtetura nga Konsulenti, kjo vonese mund te rikuperohet.

Problematika

Ecuria e Projektit ka pasur nje ngatalesim ne kohe zgjatje, i cili ka ardhur nga disa arsye:

- a) Nje suate e re projektimit e Kolektorit Jugor (NSI)
- b) Faza e tenderimit te kantrates se ndertimit u shoqerua me vonesa te theksuara nga pala Shqiptare
- c) Është në proces ligjor, (ne gjygi) realizimi i fondit për disbursimin e pronarëve të tokës për Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Kashar, Tiranë. (Deri më sot asnjë pronar nuk është paraqitur për të filluar procesin e disbursimit)
- d) Eshte pezulluar perkohesisht ndertimi i rrjetit te kanalizimeve ne zonen B (prane ures se shkozës sepse ka pasur nje mbivendosje projektesh me ARSH, projekti i reabilitimit te shtratit te lanes)

ECURIA DHE PROBLEMATIKAT E PROJEKTEVE IPA

TE IMPLEMENTUARA NGA DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN DHE TE KOORDINUARA NGA DREJTORIA E PERGJITHME E UJESJELLES KANALIZIMEVE

IPA 2007

Emertimi i Projektit: LOT 1, Golem, Kavaje

Qellimi i Projektit:

Ndertimi i Kolektorit Kryesor dhe 5 Stacioneve te pompimit per mbulimin e zones nga Perroi i Agait deri ne Qerret dhe shkarkimi ne ITUZ- Kavaje.

Financimi:

GRANT (Bashkimi Evropian)

Vlera Grantit: 4,331,426 Euro

Ecuria e Projektit

Projekti ka perfunduar dhe objekti eshte ne periudhen e garancise 1 vjecare. Objekti eshte teresisht funksional. Ky objekt eshte dorezuar zyrtarisht SHA UK Kavajes nga DPUK dhe tashme operohet dhe mirembahet nga kjo ndermarrje. Pas kalimit me sukses te periudhes se garancise do te behet dorezimi final i objektit ne gjendje te plote operative nga ana e kontraktorit.

Problematikat e Projektit

E gjithë zona ne te cilen eshte shtrire ky projekt (Perroi i Agait- Qerret- ITUZ Kavaje) tashme eshte e mbuluar me kolektor kryesor dhe stacione pompimi. Por ndertimi i kolektoreve seondare dhe lidhjet me abonentet jane nje problem akoma i pa zgjidhur. Me pjesen bashke-financuese te IPA 2007 nga ana e DPUK-se jane ne ndertim nje pjese e ketyre kolektoreve por ky investim nuk mbulon te gjithë zonen ne te cilen shtrihet kolektori kryesor dhe stacionet e pompimit.

IPA 2007

Emertimi i Projektit: LOT 2, Ura e Dajlanit- Perroi i Agait, Durres

Qellimi i Projektit: Ndertimi i Kolektorit Kryesor dhe 8 Stacioneve te pompimit per mbulimin e zones nga Ura e Dajlanit- Perroi i Agait, Durres.

Financimi: GRANT (Bashkimi Evropian)

Vlera Grantit: 9,845,498 Euro

Ecuria e Projektit

Projekti ka perfunduar dhe objekti eshte ne periudhen e garancise 1 vjecare. Objekti eshte teresisht funksional. Ky objekt eshte dorezuar zyrtarisht SHA UK Durres nga DPUK dhe tashme operohet dhe mirembahet nga kjo ndermarrje. Pas kalimit me sukses te periudhes se garancise do te behet dorezimi final i objektit ne gjendje te plote operative nga ana e kontraktorit.

Problematikat e Projektit

E gjithë zona ne te cilen eshte shtrire ky projekt (Ura e Dajlanit- Perroi i Agait) tashme eshte e mbuluar me kolektor kryesor dhe stacione pompimi. Ndertimi i kolektoreve seondare dhe lidhjet me abonentet jane ne nivel te mire. Pothuase e gjithë zona eshte e mbuluar me kete sherbim. Por perseri ka zona te cilat duhet te perfshihen nen kete sherbim dhe duhet te jene ne fokus te investimeve te ardhshme.

IPA 2007

Emertimi i Projektit: LOT 3, Lezha & Shengjini

Qellimi i Projektit: Ndertimi i Kolektoreve Kryesore qe lidhin Lezhen dhe Shengjini me ITUZ- Lezhe nepermjet 2 stacioneve te pompimit dhe ndertimi i kolektorit kryesor shkarkues nga ITUZ- Lezhe ne lumin Drin nepermjet 1 stacioni pompimi.

Financimi: GRANT (Bashkimi Evropian)

Vlera Grantit: 3,728,615 Euro

Ecuria e Projektit

Projekti ka perfunduar dhe objekti eshte teresisht funksional. Ky objekt eshte dorezuar zyrtarisht SHA UK Lezhe nga DPUK dhe tashme operohet dhe mirembahet nga kjo ndermarrje. Pas kalimit me sukses te periudhes se garancise u be dorezimi final nga ana e kontraktorit.

Problematikat e Projektit

Delegacioni i Bashkimit Evropian duke kryer nje vizite ne ITUZ Lezhe per te verifikuar gjendjen e ketij objekti ne perfundim te periudhes se garancise, ka shprehur shqetesimin e tij per menyren e operimit qe po behet nga SHA UK Lezhe. Pretendimet e tyre jane qe ky impjant nuk po operohet duke respektuar te gjithë regullat e percaktuara ne manualin e operimit dhe te mirembajtjes. Njera nga turbinat e ajrosjes nuk eshte ne funksion te plote dhe kimikatet e perdorura per trajtimin e materialit nuk jane ne sasine e kerkuar. DPUK ia ka transmetuar te gjithë porosite e DBE

ndermarrjes se ujerave ne Lezhe dhe kjo ndermarrje po merr mase per rregullimin e situates ne operimin e ITUZ- Lezhe.

IPA 2007

Emertimi i Projektit: Works 2 & 3, Shkoder & Velipoje

Qellimi i Projektit: Works 2- Ndertimi i sistemit KUZ per qytetin e Shkodres ne zonen e Unazes Lindore te qytetit (Zona Industriale).

Works 3- Ndertimi Kolektorit kryesor, 4 stacioneve te pompimit dhe Kolektoreve Sekondare per zonen e plazhit te Velipojes (Pulaj).

Financimi: GRANT (Bashkimi Evropian)

Vlera Grantit: 3,840,415 Euro

Ecuria e Projektit

Projekti ka perfunduar dhe objektet jane ne periudhen e garancise 1 vjecare. Objektet jane teresisht funksionale. Objektet jane dorezuar zyrtarisht SHA UK Shkoder dhe SHA UK Fshat Shkoder nga DPUK dhe tashme operohen dhe mirembahen nga keto ndermarrje. Pas kalimit me sukses te periudhes se garancise do te behet dorezimi final i objekteve ne gjendje te plote operative nga ana e kontraktorit.

Problematikat e Projektit

Per sistemin KUZ te ndertuar ne Shkoder nuk eshte raportuar asnje problem nga SHA UK Shkoder dhe objekti eshte teresisht operativ dhe zona eshte e mbuluar plotesisht nga ky sistem i ndertuar KUZ.

Ne zonen e Velipojes eshte ndertuar Kolektori Kryesor dhe 4 Stacione Pompimi qe e dergojne materialin ne ITUZ Velipoje, si dhe kolektoret sekondare te cilet jane shperndare ne te gjitha rruget kryesore te fshatit Pulaj. Problem mbetet lidhja e abonenteve ne sistem. Ndermarrja SHA UK Fshat Shkoder po financon ndertimin e 100 lidhjeve te para per abonentet (shtepite). Gjithashtu Komuna Velipoje ka nisur te aplikoj masa shternguese per marrjen e dokumentave te legalizimit per te gjitha shtepite qe jane ne kete proces dhe nuk jane lidhur me sistemin KUZ. Kjo komune njekohesisht po merr masa per mbylljen e te gjitha gropave septike qe nuk plotesojme standartet dhe te detyroje keta banore qe te lidhen me sistemin KUZ.

IPA 2010

Emertimi i Projektit: Works 1, Velipoje (Pulaj)

Qellimi i Projektit: Works 1- Ndertimi i ITUZ- Velipoje (faza I)

Vlera Grantit: 3,464,560 Euro

Ecuria e Projektit

Faza I e ndertimit te ITUZ- Velipoje ka perfunduar dhe objekti eshte testuar nepermjet gjeneratoreve. Pra eshte bere testimi i njesive operacionale nje e nga nje duke verejtur se te gjitha keto njesi jane ne gjendje operacionale duke punuar vecmas njera-tjetres. Kjo per arsye se furnizimi me energji i ITUZ eshte parashikuar te behet ne Fazen e II te ndertimit (Projekti- Velipoja Phase III) keshtu qe eshte e pamundur testimi i tyre duke ndervepruar me njera-tjetren. Ne keto kushte objekti eshte marre ne dorezim provizor nga DPUK dhe SHA UK Fshat Shkoder me kushtin qe ne momentin e lidhjes me energji te impjantit te kryhet nje test i plote operacional dhe pastaj te behej dorezimi final nga ana e kontraktorit.

Problematikat e Projektit

Projekti parashikonte qe kontraktori te kishte edhe nje kontrate tjeter me Delegacionin e Bashkimit Evropian objekti i se ciles do te ishte "Operimi dhe mirembajtja e ITUZ- Velipoje per nje periudhe 1 vjecare". Ky operim nga ana e kontraktorit do te siguronte perfundimisht qe ITUZ-ja te ishte operative dhe te kishte nje staf te trajnuar ne operimin e saj qe do te propozohej nga SHA UK Fshat Shkoder. Kjo marreveshje nuk arriti te implementohet per shkak te mos arrijtes se nje konsensusi ndermjet DBE dhe Kontraktorit ne cmimin mujor te operimit. Realisht kjo suate e sjell kete faze te ndertimit te vepres perballe dilemave serioze ne funksionimin e saj. DPUK ka insistuar fort ne te gjitha mbledhjet e zhvilluara per kete arsye qe kjo kontrate te mos digjej dhe e ka konsideruar gjithmone si nje kontrate me rendesi jetike per kete veper. Megjithate i takon DBE te marre nje vendim. Nga

ana tjetër DPUK nuk do të pranojë në asnjë rast të marrë në dorezim final objektin pa u testuar në ngarkesë maksimale pasi të ketë mbaruar lidhja me rrjetin energjetik.

IPA 2009

Emertimi i Projektit: LËT 1, LOT 2, LOT 3- Vlora, Ksamili, Kavaja, Shengjini

Qellimi i Projektit: Lot 1- Ndertimi i sistemit KUZ në Vlorë (Në qendër të qytetit), Ndertimi i sistemit KUZ në Ksamil dhe ndertimi i kolektorit kryesor dhe 6 Stacione pompimi që lidh Ksamilin me ITUZ- Sarandë

Lot 2- Zgjerimi i ITUZ- Kavaje

Lot 3- Ndertim sistemi KUZ në Shengjin, Ndertimi i kolektorit kryesor me 3 Stacione Pompimi që lidh Shetitoren e Shengjinit, Rrugën e Kunes me Stacionin e Vjetër të Pompimit (Rehabilitim) në Shengjin i cili me pas derdhet në ITUZ- Lezhë

Vlera Grantit: 14,381,885 Euro

Ecuria e Projektit

Në përgjithësi projekti ka ecur me ritme me të ngadalta sesa ato të parashikuara në kontratën fillestare. Një ndërprerje e këtij projekti është bërë për një periudhë afro 1 vjetare. Arsyeja është falimentimi i njerit prej partnerëve të Kontraktorit. Zevendesimi i partnerit dhe miratimi nga DBE bëri që projekti të rifillonte. Përseri ritmet e punës së Kontraktorit të ri janë shumë poshtë mesatares së parashikuar. Megjithatë projekti po zbatohet normalisht në cilësinë e punimeve dhe pa ndërprerje të tjera.

Problematikat e Projektit

Problemi kryesor i projektit është vëllimi më i vogël i realizimit të punimeve në krahasim me kushtet e kontratës. Problematikat e ndryshme të punës së perdritshme janë zgjidhur me një bashkëpunim të mirë ndërmjet DBE, DPUK, Konsulentit dhe Kontraktorit. Nuk ka probleme bllokuese për projektin.

IPA 2011

Emertimi i Projektit: Phase III, Zona e Velipojës

Qellimi i Projektit: Ndertimi i sistemit KUZ në Velipojë me të gjithë elementet e tij (kolektor kryesor, Stacione pompimi, kolektore sekondare), Lidhja me rrjetin energjetik dhe zgjerimi i ITUZ- Velipojë.

Financimi: GRANT (Bashkimi Evropian)

Vlera Grantit: 7,989,373 Euro

Ecuria e Projektit

Projekti po ecen me ritme të mira sipas parashikimeve të kontratës. Kontraktori ka realizuar një cilësi të mirë punimesh dhe vëllimet janë në nivelin e parashikuar. Parashikohet që në muajin shkurt 2015 ITUZ të lidhet me rrjetin energjetik duke bërë kështu edhe testimin final për ndertimin e fazës së I të tij.

Problematikat e Projektit

Problematikat e ndryshme të punës së perdritshme janë zgjidhur me një bashkëpunim të mirë ndërmjet DBE, DPUK, Konsulentit dhe Kontraktorit. Nuk ka probleme bllokuese për projektin. Realizimi i lidhjeve me abonentët është një sfidë e ndërmarrjes SHA UK Fshat Shkoder dhe Komunes së Velipojës. Ndermarrja SHA UK Fshat Shkoder po financon ndertimin e 100 lidhjeve të para për abonentët (shtepite). Gjithashtu Komuna Velipojë ka nisur të aplikojë masa shternguesë për marrjen e dokumentave të legalizimit për të gjithë shtepite që janë në këtë proces dhe nuk janë lidhur me sistemin KUZ. Kjo komunë njëkohësisht po merr masa për mbylljen e të gjitha gropave septike që nuk plotësojnë standartet dhe të detyrojnë këta banorë që të lidhen me sistemin KUZ.

Objektivat e DPUK-së për vitin 2015

Analiza e vitit 2014 na mundësoi identifikimin e problematikës që mbart në vetvete sektori si në aspektin teknik, financiar, e menaxherial ashtu edhe në atë ligjor e institucional.

E gjithë puna jonë, politikat e qeverisë, investimet dhe monitorimi, janë në funksion të sigurimit të shërbimeve sa më cilësore, ujë cilësisht të pastër 24 orë në ditë, me kosto të ulët dhe me tarifa të përballueshme për të gjithë qytetarët e vendit, kanalizime të sigurt dhe trajtim të ujrave të ndotura sipas standardeve të BE-së.

Për këto arsye, veç punës së mirë që është bërë nga stafi i DPUK-së për realizimin e objektivave të vitit 2014, të cilin gjej vendin për ta falenderuar, shumë gjëra duhet të ndryshojnë në punën e të gjithëve, për vitin 2015.

✓ Së pari mendoj se duhet të ndryshojnë politikat e qeverisë për sa i përket mënyrës së organizimit dhe administrimit të sektorit në përputhje me ndryshimet territoriale të vendit. **Reforma** që të gjithë jemi duke punuar, mendoj se do ti japë orientimin e duhur jo vetëm mirëorganizimit të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve por edhe institucioneve sipas përkatësisë funksionale të tyre;

✓ Përditësimi i **Strategjisë** sektoriale dhe caktimi i objektivave më agresive, për të ecur më shpejt, drejt arritjes së standardeve të BE-së, si dhe siguri i burimeve të nevojshme të financimit, është domosdoshmëri për realizimin e objektivave. Kjo do të jetë puna jonë të cilën duhet ta ndjekim ritmiksht çdo ditë në 2015.

✓ Do të punojmë në mënyrë të tillë që **Investimet** të jenë më të plota, të mirëstudjuara, të orientuara nga performanca dhe të bazuara në Master Planin Kombëtar, i cili gjithashtu duhet të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Intensifikimi i investimeve në matjen e prodhimit dhe konsumit të ujit të pijshëm, duhet të shikohet me përparësi;

✓ **Subvencionet**, ka ardhur koha të orientohen drejt shtresave të varfra të popullsisë, jo për shlyerjen e faturave të pa paguara duke mbuluar në këtë mënyrë keqmenaxhimin e shoqërisë. Për këtë është e nevojshme të hartohet baza ligjore, të krijohet infrastruktura e nevojshme me bazën përkatëse të të dhënave dhe njëkohësisht, duhet të rritet niveli i bashkëpunimit me institucionet si Ministria e Punës e Mirëqenies Sociale, ERRU, etj.

✓ Forcimi dhe zgjerimi i **monitorimit**, rritja e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit, janë gjithashtu ndër objektivat tona për të cilat do bëjmë të gjitha përpjekjet, ti realizojmë brenda një kohe optimale sa më të shkurtër e me përgjegjësi të lartë.

✓ Krijimi dhe perfeksionimi i stafit të një njësie të përhershme, për **trainimin dhe rritjen e kapaciteteve menaxhuese** në sektor si dhe çertifikimin profesional të tyre, është gjithashtu një ndër sfidat tona, realizimi i së cilës do të shoqërohet me një koncept të ri menaxhimi për shërbimet e UK.

Rritja e kapaciteteve teknike e njerëzore në sektor si dhe përmirësimi i mënyrës së funksionimit të shoqërive, do të çojë në një menaxhim më të mirë të kërkesës për ujë, në reduktimin e humbjeve e të kostove të pa dobishme.

Gjej vendin për të bërë disa rekomandime zoti ministër dhe nëpërmjet Jush qeverisë. Për të qënë të suksesshëm në realizimin e objektivave për vitin 2015, duhet të merren të gjitha masat për përmirësimin e Rregullimit, Menaxhimit dhe Adresimit më të mirë të përgjegjësi.

✓ Krijimi i një Njësie Menaxhimi dhe Mbështetje financiare për impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura për një periudhë 4-5 vjeçare si dhe Përgatitja e

legjislacionit për administrimin dhe menaxhimin e impianteve të trajtimit të ujrave të zeza;

- ✓ Duhet të garantohet Liçensimi i subjekteve, që realisht kanë aftësi profesionale dhe financiare për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve;
- ✓ Tarifat duhet të jenë të mirëstudiuara për të inkurajuar rritjen e të ardhurave nëpërmjet reduktimit të humbjeve. Vetëm në këtë mënyrë do të gjenerohen të ardhurat e nevojshme për mbulimin e kostove duke garantuar qëndrueshmëri financiare për ofruesit e shërbimeve;
- ✓ Transparenca me publikun për investimet, tarifat e shërbimeve duke qënë mjet i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit dhe rritjen e arkëtimeve, duhet të zhvillohet e ngritur në një nivel më të lartë nga institucionet përkatëse.

Ato çka përmenda më sipër në lidhje me politikat, investimet, menaxhimin dhe rregullimin, gërshetuar me një Adresim më të mirë të përgjegjësive në të gjitha nivelet, qëndror, lokal, atë administrativ e në bashkëpunim edhe me publikun, do të mundësojë shërbime më cilësorë për qytetarët ecje me hapa më të shpejtë drejt standardeve të BE-së, ku duam të bëhemi pjesë.

Ardian Alushi

Drejtor i Përgjithshëm